

Fletore e Demokracisë

Etika dhe Zgjedhjet

Fletore e Demokracisë

Etika dhe Zgjedhjet



Lejohet prezantimi, kopjimi dhe shpërndarja e librit në tërësi apo në pjesë, me kusht që: (a) materialet të përdoren duke i njohur USAID-it dhe NDI-së autorësinë e botimit, (b) ky libër do të shërbejë vetëm për përdorim informativ, jo-tregtar dhe personal, (c) të mos bëhen modifikime të këtij libri.

Ky libër u mundësua përmes mbështetjes së ofruar nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nën Marrëveshjen Bashkëpunuese (Cooperative Agreement) Nr. 182-A-00-04-00104-00 me NDI. Opinione të shprehura në këtë botim janë të vetë autorëve dhe si të tilla nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID.

Anëtarët e bordit botues janë vullnetarë dhe veprojnë si individë privatë, dhe ata janë: Prof. Dr. Rexhep Meidani, ish-President i Republikës së Shqipërisë; Sabri Godo, President i Asamblesë Kombëtare të Partisë Republikane; Andrea Stefani, Këshilltari i Lartë për Median, Konsorciumi DGA/IREX; Barry Reed, Drejtor, Qeveria Lokale dhe Decentralizimi në Shqipëri (USAID); Gent Ibrahim, Drejtir Ekzekutiv, Instituti për Politikë & Studime Ligjore; Ilir Aliaj, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për Zhvillimin & Demokratizimin e Institucioneve; Pjerin Marku, Drejtor Ekzekutiv, Koalicioni Shqiptar Kundër Korrupsionit; Dr. Teuta Starova, Shefe e Departamentit Filozofi-Sociologji, Universiteti i Tiranës. Jennifer L. Butz, Drejtoresh e Konsorciumi DGA/NDI; Aleksandër Çipa, Konsorciumi DGA/IREX; Dan Redford, Këshilltari i Lartë për Partitë Politike dhe Procesin Zgjedhor, Konsorciumi DGA/NDI.

Botuar nga Shtëpia Botuese "PEGI"

Rruga e Elbasanit, Pallatet Fratari, Filipeu Nr.2, Tiranë

Tel: +04 374947

Fax: +04 374947

Përgatitur nga National Democratic Institute for International Affairs

Faqesja: Erald Velmishi

ISBN: 99943-705-6-1



Përmbajtja

• Parathënia	VI
• Dy fjalë për kontribuesit	IX
1. Për një etikë normale në politikë <i>Prof. Dr. Rexhep Meidani</i>	1
2. Ndershmëria në pjesëmarrje <i>Sue Nelson</i>	15
3. Politika e llogoreve e ka mbaruar kohën e saj <i>Preç Zogaj</i>	27
4. Etika në fushatën zgjedhore <i>Petro Koçi</i>	31
5. Etika si shprehje e pjekurisë së mediave dhe demokracisë <i>Aleksandër Çipa</i>	35
6. Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)	41

Parathënie

Mirësevini në numrin e parë të *Fletore e Demokracisë* prodhim i Konsorciumit Demokraci dhe Qeverisje ne Shqipëri (DGA), i cili përfshin National Democratic Institute (NDI), IREX dhe Partnerët-Shqipëri dhe është financuar nga USAID.

Fletore e Demokracisë do të jetë një hapësirë publike për gazetarinë investigative, idetë e qytetarëve për një qeverisje më të mirë, veprimtarët e organizatave jo-qeveritare, politikanët, akademikët. *Fletore e Demokracisë* do të hapë një shteg drejt një shqyrtimi më të thellë të parimeve dhe praktikave të demokracisë bashkëkohore. *Fletore e Demokracisë* do të shrihet për një audiencë të gjerë dhe do të shpërndahet nëpërmjet OJQ-ve, qendrave të medias, rrjeteve të partive politike, shkollave të mesme dhe universiteteve. Çdo numër i "*Fletores*" do të përqendrohet rreth një teme që do të përcaktohet nga Bordi Botues.

Në numrin e parë, pesë autorë eksplorojnë idenë e etikës në jetën publike me qëllimin të ndikojnë që zgjedhjet e ardhshme të karakterizohen nga sjelljet etike. Ne falenderojmë seicilin nga autorët kontribues për idetë e tyre të thella dhe gatishmërinë për të ofruar opinionet nga këndvështrimi i tyre me epërsi të veçantë.

Në artikullin e parë, "Drejt një Etike Normale në Politikë: Çështje të Individit dhe Shoqërisë" ish-Presidenti I Shqipërisë, Prof. Dr. Rexhep Meidani hedh vështrimin në shtrate të ndryshme të jetës pulike dhe politike shqiptare, vlerëson praktikat ekzistuese duke i krahasuar ato me standartet e pranuar ndërkombëtare. Ai ekspozon etikën publike përgjatë tre linjave: politike, civile dhe

shoqërore. Brenda grupit të parë ai ndalet të ndarja e ideologjive politike në shumë parti si përbërës i maturisë politike. Duke e ndarë etikën politike në dysh: gjatë zgjedhjeve dhe në “kohën e harruar” mes zgjedhjeve, Prof. Dr. Meidani e sfidon lexuesin duke i kërkuar të mendojë për një përkufizim të plotë të përgjegjësisë politike. Duke parë për nga e ardhmja autori vëren se etikës mund t’i shërbehet atëhere kur idetë, veprimet dhe reformat karakterizojnë partitë politike dhe jo vetëm atë që shohim sot. Ai eksploron ndryshimin mes qytetarit aktiv dhe qytetarit spektator dhe citon një numër aksionesh dhe tiparësh që do të mund të forconin jo vetëm etikën në formë abstrakte por që do të kontribuonin direkt në zhvillimin e kulturës demokratike të Shqipërisë.

Artikulli i dytë është një kontribut nga një autorë e huaj mbi etikën e forcave politike gjatë fushatave zgjedhore. Është një ekstrakt marrë nga një esse më e detajuar, “Ndershmira në Pjesëmarrje”, i publikuar me lejen e autorit që është Sue Nelson i projektit ACE. Zonja Nelson shqyrton problemet etike dhe rreziqet përgjatë një procesi të plotë elektoral – nga përzgjedhja e kandidatëve të financimi i fushatave të partive, duke përkufizuar çështjet dhe ofruar zgjidhje praktike për secilën pikë. (Në numërin tjetër të “*Fletore e Demokracisë*” ne do të publikojmë një pjesë në vazhdim nga Zonja Nelson dhe që bën fjalë mbi rolin e vëzhguesve të partive politike në zgjedhje).

Dy artikujt e tjerë janë kontribute të politikanëve shqiptarë, që shkruajnë nga pozicione vetjake duke shpalosur preceptimet e tyre për etikën dhe zgjedhjet ndërsa kombi i afrohet ditës së votimit. Preç Zogaj (PD) pohon se problemet e politikës shqiptare janë direkt të lidhura me çështjet e kulturës që janë trashëgimi e epokës komuniste. Zoti Zogaj bën kronikën e zgjedhjeve të fundit dhe vendimeve politike kyçe duke konkluduar se koha për hiperbolizime nga secila palë nuk është më e justifikuar. Duke e krahasuar procesin elektoral të epokës demokratike në Shqipëri me një sport, Petro Koçi (PS) ekspozon nëntë parime specifike të qarta dhe mirëpërkufizuara, në bazë të të cilave duhet të zhvillohen këto dhe zgjedhjet në të ardhmen.

Artikulli final në këtë numër inauguroes është nga Aleksandër Çipa, një gazetar që vendos lidhjen mes mungesës së besimit të politika dhe drejtimit të medias për sa kohë që tranzicioni fillon i bazuar në tre faktorë kontribues. Duke e shëtitur lexuesin nëpër

këta faktorë, Çipa përfundon artikullin me sugjerimin për kolegët e tij të medias për t'i kontribuar një roli gjithnjë e më të pjekur që media duhet të luajë në këtë cikël zgjedhesh.

Konsorciumi DGA mirëpret mendimet tuaja për këta artikuj dhe idetë që ata prezantojnë. Është shpresa dhe qëllimi ynë që lexues të përzgjedhur të përfshihen në të ardhmen në publikimet e *Fletore e Demokracisë*. Ne dëshirojmë që letrat tuaja të pasqyrojnë parimet që ne kemi shpalosur për këtë botim: Konstruktiviteti, shikimi përpara dhe praktikabiliteti. Dërgoni letra në: *Fletore e Demokracisë*, Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri. Rr. "Pjetër Bogdani", Nr. 41, Tiranë.

Jennifer L. Butz
Drejtoreshë Vendore, NDI/Shqipëri
Drejtoreshë e Konsorciumit Demokraci dhe Qeverisje në
Shqipëri (DGA)

Tiranë – Maj 2005

Dy fjalë për kontribuesit

Prof. Dr. Rexhep Meidani

Ish President i Republikës së Shqipërisë

Sue Nelson

Këshilltare e Pavarur e Zgjedhjeve

Preç Zogaj

Deputet në Kuvendin e Shqipërisë

Petro Koçi

Deputet në Kuvendin e Shqipërisë

Aleksandër Çipa

Gazetar, analist

1. Për një etikë normale në politikë

Prof. Dr. Rexhep Meidani

Çështje e individit dhe e shoqërisë

Çdo aksion njerëzor, normalisht, krahas përmbajtjes, e ka si pikënisjen, ashtu dhe rezultatin e tij. Në një plan shumë më të gjerë të veprimit njerëzor, vlerësimi nëse përmbajtja apo dhe pikënisja e rezultati kanë qenë të drejtë apo të gabuar, mund të ndikohet edhe nga disa kritere e synime më të përgjithshëm, që krahas kushtëzimit nga legjislati në fuqi, përcaktohen dhe nga morali, tradita apo etika shoqërore e kohës. Pak a shumë ato së bashku përbëjnë dhe cilësinë e sjelljes dhe të jetës individuale brenda një mjedisi të caktuar shoqëror. Nga e kjo “teknologji” vlerësuese nuk mund të shpëtojë as individ politik, që, për më tepër, në çdo moment është para syrit e veshit të publikut, ku dhe i “shoshiten” fjala e mendimi, sjellja e veprimi, ndershmëria e korrektësia e tyre. Dhe elementë të tillë, sidomos ato me përmbajtje etike, nuk duhet dhe nuk mund të neglizhohen për çdo përzgjedhje të drejtë politike. Por kjo nuk duket që po merret seriozisht parasysh në përzgjedhjen e të gjithë kandidatëve.

Në përgjithësi, sjellja, synimet, veprimet e objektivat personalë, nuk varen vetëm nga arsyeja e shumicës, por dhe sjellja e dispozitat individuale, morali, prirjet e emocionet, pëlqimet e mospëlqimet, kontradiktat e brendshme, që së bashku përbëjnë dhe thelbin e individit, pra dhe karakterin e tij. Jo pa rol janë dhe faktorë të jashtëm si: raportet e veçanta shoqërore, mjedisi rrethues, edukimi,

shëndeti, situata ekonomike, e kaluara e tij, etj. Të gjitha këto, pa dyshim lënë gjurma, diku për mirë, e diku për keq, dhe nuk mund të mos pasqyrohen në mënyrë të natyrshme tek individ, pjesë e kësaj shoqërie, dhe mbi të gjitha tek individ politik, sidomos kur ai “mbart” diçka dhe nga e kaluara e tij politike. Nisur nga ky arsytim, nuk mund të mohohet që aspekti i dytë negativ është shfaqur jo pak në politikën shqiptare të pluralizmit e tranzicionit demokratik. Individë të veçantë, duke trashëguar elementë ideologjikë e partiakë nga diktatura komuniste apo sistemi partishtet, në mënyrë të pandërgjegjshme apo të ndërgjegjshme i kanë transmetuar gjurma të tilla në frymën autokratike të drejtimit të partisë, në mënyrën e strukturimit dhe përzgjedhjes së kuadrove drejtues të saj, të komunikimit e transmetimit të mesazhit politik, të respektimit të ligjit, të manipulimit me fjalën dhe me të vërtetën për “hir” të interesit individual ose të partisë, etj. Kjo është shoqëruar dhe me shformime jo të vogla e tensione politike-etike në jetën partiake pluraliste shqiptare, të shfaqur me një theks më të veçantë gjatë fushatave zgjedhore.

Kështu na ka ndodhur që ajo që më parë ishte p.sh. një cilësi pozitive apo virtyt (e shprehur si ndershmëri, korrektësi e respekt i ndërsjellë, si dinjitet, kurajë individuale e guxim qytetar, si sjellje e drejtë, e urtë dhe e moderuar, si mirësi, dhembshuri e ndihmesë njerëzore, etj.) në një rrafsh të ri të “sajuar” (politik, shoqëror, psikologjik apo etik) nuk shihet më tërësisht (edhe pse artificialisht) si e tillë. Madje, siç po propagandohet sot tek ne, fare pa “kujdes”, po na kthehen në “virtyte” mediatike-shoqërore deri “kuraja absolute” për pushtet, për fitim e pasuri në radhët e disa individëve të politikës, nëpërmjet “ethes së pushtetit” e demagogjisë, apo dhe abuzimit e përplasjes konfliktuale të interesave.

Prandaj me të drejtë përgjigjen e pyetjes - A janë këto çështje vetëm të politikës, të ekzistencës së disa individëve të saj “protagonistë” apo dhe e tërë shoqërisë? - mund t’ua faturosh me të drejtë dhe grupimeve partiake e strukturave të tyre, mungesës apo ndërprerjes së procesit demokratik të reformimit të tyre, aq të domosdoshëm në kushtet e sotme, madje dhe bashkësive të tjera shoqërore e emancipimit demokratik të tyre.

Urtësia e matura në politikë

Pohimet për të mirën apo të keqen, për të drejtën apo të gabuarën, për përmbajtjen, pikënisjen apo rezultatin, kanë vlerë përgjithësuese dhe për çdo aksion politik e partiak. Për ilustrim mund të merret dhe një rast mjaft i ndeshur në jetën tonë partiake. P.sh., po të hidhet një sy mbi copëzimet apo “lindjet” e shpejta dhe të kohëpaskohshme partiake në politikën shqiptare, e ndjen se diçka e “mundon” jo pak atë dhe lidshimin e saj. Fillimisht, në krahun e djathtë, me shkëputjet e shumta nga PD-ja dhe krijimin e disa partive të reja si PAD-së, PDD-së, PLD-së, PDR-së, etj., me ndarjet në dysh të PBK-së, PLL-së apo të vetë PDR-së, dhe sidomos, në këto dy vitet e fundit, në krahun e partive përbërëse të koalicionit qeveritar, si brenda PS-së me shkëputjen e LSI-së po ashtu dhe të disa partive më të vogla, aleate të saj si PAD-së, PSD-së, PBDNJ-it. Edhe pse në ndonjë rast kjo mund të lidhet dhe me ndonjë dëshirë të “tepruar” individuale për të mbetur me çdo “kusht” në politikë, përsëri nuk mund të mos shtrohet pyetja: A është copëzimi për këto parti një pikënisje apo rezultat i drejtë ose i gabuar? Natyrshëm, përgjigja e saj varet si nga interpretimi e faktori subjektiv, ashtu dhe nga rrethanat konkrete objektive në këto kampe. Këtë e ilustron dhe fakti i fundit pozitiv, iniciuar nga PD-ja për bashkim (“sintezë”), në vend të copëtimit (“analizës”) të dikurshëm. Por, pavarësisht nga to, ajo që mund të pohohet, pa pozicion “gjykatësi”, është dhe fakti objektiv që, ndryshe nga ajo që deklarohet, etika demokratike brenda partive shqiptare, vetë demokracia partiake ende është “kolektivisht” e prapambetur dhe “individualisht” refraktare për të pranuar ndryshimin e të ndryshmen, mendimin e vendimmarrjen alternative, konkurrencën e lirë dhe garën demokratike, frymën kolegjiale e jo autokratike brenda saj. Madje, po të përkufizohet më saktë realiteti partiak, pavarësisht “lustrimeve” deklarative apo “zburimeve” liberale të kohëpaskohshme, mund të pohohet se aty më shumë se me demokraci kemi të bëjmë me unitarizëm, ose, e thënë ndryshe, me “bajraktarizëm” apo “klanokraci”.

Në “mbarsjen” e kësaj situatë, krahas trashëgimisë negative individuale e kolektive, nuk përjashtohet dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë e faktorit subjektiv kryesor. Për më tepër, në një rrafsh më të gjerë, në politikën shqiptare, në përgjithësi, e sidomos në jetën e brendshme të dy partive më të mëdha, në veçanti, na përzihen, madje na zëvendësohen në mënyrë jo etike, deri të “pamëshirshme”, aspekti racional, liberal e vullnetar me atë komandues e “uzurpues”, aspekti shpirtëror me atë dëshiror (oreksor)! Kurse urtësia e maturia, për fat të keq, na rreshtohen në fund të konsideratës politike e partiake ose përjashtohen me “duartrokitje” e “brohoritje” njëmërore prej “masës” së saj! Ndërkohë, që po të futemi në labirintet e Platonit (në veprën e tij madhore “Republika”), në hierarkinë e virtyteve, urtësia (sophia) e maturia - si virtyte njerëzore e intelektuale përbëjnë dhe bazamentin e të gjithë virtyteve të tjera. Dhe kjo, siç vlen për situatën tonë të sotme shoqërore, merr theks më të veçantë për politikën aktuale, që vetëm e urtë dhe e matur nuk mund të konsiderohet në nivelin e udhëheqjes partiake dhe të veprimtarisë konkrete të saj. Mjafton të kujtohen shërret e mëdha të vazhdueshme, deri goditjet institucionale, ose “lojërat e kungulleshës” në séance parlamentare, etj., për ta kuptuar më së miri një gjë të tillë.

Prandaj me të drejtë mund të shtrohet pyetja: A kemi ende kohë që në “pedestalin” e politikës të afishohet, në radhë të parë, urtësia e maturia? Duket se mund të shpresohet, por ama, ato nuk mund të bashkëjetojnë etikisht aty me gënjeshttrat e “shpikjet” spekulative, “pështymje-lëpirjet” apo “faljet” e vonuara e thjesht për fushatë, nga njëra anë, dhe me “entuziazmin patetik”, vetëdashurinë e hapur apo të fshehtë të lidërsipit, “purifikimin mistik” apo “inspirimet poetike”, shumë larg realitetit dhe kërkesave konkrete të qytetarëve, nga ana tjetër. Po ashtu, mbi të gjitha, problematike në këtë lloj “moralit” ose, më saktë, pseudo-moralit është dhe etika e dyfishtë që shfaqet qartë në udhëheqje të partive, sidomos në ato kryesore, Kjo etikë e dyfishtë, në mënyrë të veçantë, shfaqet në dallimin e thellë të veprimit, sjelljes e deklarimit para një fushate zgjedhore, me atë në periudhën e “harruar” disa vjeçare midis dy proceseve zgjedhore. E para, në prag fushate, mund të tipizohet nga: një sjellje euforike, e mbushur me realizime e

“buzëqeshje” (pozita); një sjellje tërësisht mohuese, e mbushur me “sharje militante” (opozita) dhe plot premtime të pabazuara, “puthje-përqaqime” dhe përkujdesje kolektive (pozitë-opozitë pa dallim). Kurse, e dyta, pas zgjedhjeve, me një indiferencë e mospërfillje të theksuar, me harresë apo sajësë “meritokracie”, nga njëra anë apo përkujdesje thjesht partizane e neopotike e lojë politike jashtboshitore, bllokuese e shtyrëse, jashtë interesave të drejtpërdrejta të qytetarit, nga ana tjetër. Dhe kjo jo vetëm në nivelin qendror.

Cilit t'i besojmë variantit numër një, apo variantit numër dy, ndërkohë që dhe besimi kolektiv e publik për t'u ndërtuar e rindërtuar, si proces kohor kërkon kohën e nevojshme për tretje të drejtë dhe vote të merituar, sidomos për atë që deri më sot ka qenë thjesht një “votë” abstenuese?

Mbi qytetarinë demokratike

Duke hedhur një vështrim të shpejtë mbi zhvillimet politike të tranzicionit shqiptar rezulton se në momente të ndryshme pushteti nuk është ushtruar gjithmonë apo plotësisht nga strukturat kushtetuese (ekzekutivi, legjislativi, gjyqësori), por është paralelizuar deri zëvendësuar, në forma të ndryshme, nga struktura të tjera si: a) institucionet partiake, drejtuesit e operatorët politiko-partiakë (në kurriz të autoritetit ligjor të institucioneve kushtetuese) b) grupet ekonomike e financiare, përfshirë aty këtu dhe pjesë të medias; c) forcat e sigurisë (policia, ShIK-u, Forcat e Armatosura); d) faktorë të jashtëm (si disa agjenci e institucione ndërkombëtare apo operacione konkrete civile e ushtarake në periudha krizash, etj.). Sidomos roli parësor i grupit c) u shfaq mjaft qartë gjatë krizës së rëndë të skemave piramidale. Po kështu, nëse koncepti partiak i qeverisjes ishte një përbërëse me peshë e qeverisjes demokratike, gjatë viteve të fundit të qeverisjes socialiste është rinxjerrë fuqimisht, në një plan të parë, koncepti mbetës i partisë-shtet, apo i akumulimit të pushtetit në duart e një individi. Njëkohësisht, kohët e fundit, është rritur mjaft dhe roli “pushtet-bërës” i disa operatorëve të “profilizuar” ekonomiko-financiarë e mediatikë! Aq më keq, nga pikëpamja ligjore e etike, kur midis tyre janë jo të pakët dhe vetë politikanë e shtetarë

mekonflikte të hapur interesash.

Ka shumë mundësi që të vazhdohet me shformime edhe në të ardhmen nëse nuk do të bëhet asnjë përpjekje, që sot, për të ndërgjegjësuar, nxitur, ligjëruar e zhvilluar sa më gjerësisht pjesëmarrjen aktive qytetare, sidomos midis dy proceseve zgjedhore. Pa këtë pjesëmarrje, në kushte “paralize” të strukturave kufizuese të pushtetit qeverisës, edhe vetë zhvillimi demokratik do të vazhdojë të shfaqë, si deri më sot, dobësi jo të vogla.

Pa iu futur ndonjë trajtimi të thellë teorik, nuk mund të mohohet se, në kuptimin praktik, procesi i demokratizimit ka dhe një përmasë thellësisht procedurale. Kjo përmbledh në vetvete ndërtimin e një sistemi rregullash që mundëson një garë paqësore e normale për pushtet, vetëkuptohet nëpërmjet një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm e të barabartë. Por demokracia nuk është vetëm zgjedhje. Madje, për të arritur optimumin në vetë procesin e demokratizimit nevojitet, në radhë të parë, një pjesëmarrje sa më e plotë e qytetarëve, ushtrimi prej tyre i të drejtave politike, civile e sociale. Përndryshe, pa pjesëmarrjen qytetare, edhe me një sistem shumë të mirë rregullash, nuk mund të mendohet që demokracia do të zhvillohet në mënyrë plotësisht të shëndetshme, aq më pak që ajo të mbetet e tillë. Në këtë optikë, vetë procesi i lirë dhe i ndershëm zgjedhor është vetëm një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për ndërtimin e konsolidimin e sistemit demokratik.

Duke iu njohur të gjithë njerëzve në moshë të caktuar një barazi politike formale nuk gjenerohet pa tjetër dëshira ose kapaciteti i plotë i tyre për të marrë pjesë në procesin politik apo për të ndikuar patjetër ose me të njëjtën peshë në rezultatet politike përkatëse. Aq më problematike mund të bëhet kjo situatë, kur dhe tentohet të abuzohet me votën e qytetarit. Sidomos, apatia qytetare, zhbalancimet në burime dhe vetë pushteti politik, në një mënyrë apo në një tjetër, mund të shformojnë zbatimin e parimit “një njeri, një zë apo një votë”, pra dhe forcën reale e stabilitetin politik të përfaqësimit të institucioneve të derivuara në zbatim të tij. Kjo çështje shtrohet edhe për zgjedhjet e ardhshme.

Për fat të keq, ende dhe sot, politika shqiptare merret më shumë me pjesën formale, shpenzon një kohë dhe energji mjaft të çmueshme vetëm për rregullime (apo çrregullime) ligjore-procedurale, dhe lë praktikisht mënjanë rolin aktiv qytetar,

ndërgjegjësimin, pjesëmarrjen e kërkesën e llogarisë qytetare, sidomos në periudhën midis dy proceseve zgjedhore. Kjo kërkon me urgjencë dhe konceptime të reja për rregullimin e raportit: qytetar aktor-qytetar spektator në favor të parit, përndryshe pjesëmarrja në votime në zgjedhjet e ardhshme mund të pësojë një ulje tjetër, ndoshta, zhgënjyese për partitë kryesore. Ndërkohë që këto të fundit merren pa u lodhur me njëra-tjetrën me deklarime lloj llojesh, herë me kontradikta e herë me marrëveshje, herë me “fitore” e herë me “humbje”, ato vazhdojnë ta llogarisin pjesëmarrjen qytetare në mënyrë formale e vetëm për “fushatë”, duke e identifikuar atë gabimisht me militantizmin “zgjedhor” partiak!

Por demokracia është më shumë se e ashtuquajtura “demokracia zgjedhore”. Ajo është në radhë të parë një mënyrë e organizmit të shoqërisë për të mbrojtur dhe zgjeruar të drejtat e individëve. Pikërisht kjo është demokracia e vërtetë, “demokracia e qytetarëve” apo “qytetaria demokratike”. Në thelbin e saj ajo mbështetet në tri kolona të mëdha apo karakterizohet nga tri përmasa: nga ajo politike, nga përmasa civile dhe ajo sociale.

Qytetaria politike, si përbërëse kryesore e qytetarisë demokratike, ka të bëjë me të drejtën për të marrë pjesë në ushtrimin e pushtetit politik: si anëtar i një organizmi të veshur me autoritet politik, si i zgjedhur apo zgjedhës i anëtarëve të këtij organizmi (forumeve partiakë, deputetëve të kuvendit, institucionit të kryetarit të komunës, bashkisë apo anëtarëve të këshillave vendorë). Në këtë aspekt nuk mund të mohohet progresi 14 vjeçar, sidomos gjatë procesit zgjedhor, ndërkohë që periudha midis dy proceseve zgjedhore, në shumtën e rasteve karakterizohet nga mungesa, indiferenca e apatia e një qytetarie të organizuar e llogari-kërkuese. Në ndryshim e plotësim të qytetarisë politike, qytetaria civile ka të bëjë me të drejtat e liritë individuale, me lirinë e zgjedhjes së individit, me lirinë e shprehjes, mendimit, fesë e të organizimit. Po ashtu ajo përfshin dhe të drejtën e pronës (fizike ose intelektuale), të drejtën për të marrë pjesë në kontrata të rregullta apo për të kërkuar drejtësi nëpërmjet ligjit. Edhe kjo kolonë paraqet shqetësime serioze në një pjesë të përbërësve të saj, sidomos në periudhën e fundit me uljen e efektivitetit qeverisës, rritjen e ndikimit monopolist e korrupsionit administrativ,

të trajtimit të paqartë, deri abuziv, të pronës, etj. Së fundi, qytetaria sociale mbulon një gamë të gjerë çështjesh, nga e drejta për siguri njerëzore dhe garantimin e një minimumi jetik apo mirëqenieje, deri tek e drejta për ndarje të barabartë të trashëgimisë sociale, sidomos për çështje thelbësore si edukimi, kujdesi shëndetësor e ruajtja e mjedisit, në përputhje me standardin mesatar të shoqërisë.

Sidoqoftë, mund të veçohen dy aspekte të qytetarisë sociale: ai i “nevojave” bazë, ku edukimi dhe shëndeti mbeten parësorë dhe “integrimi social”, që lidhet me punësimin, luftën ndaj varfërisë dhe pabarazisë së theksuar midis individëve apo rajoneve të ndryshme. Megjithëse treguesi i zhvillimit njerëzor ka pësuar ngritje (nga vlera 0.740 në vitin 2000 në vlerën 0.781 në vitin 2002, duke i dhënë Shqipërisë vendin e 65-të midis 177 vendesh, UNDP Human Development Report 2004) nuk mund të mohohet se problemet e renda ekonomiko-sociale, në një përqindje të konsiderueshme të popullsisë, krijojnë barriera serioze për zhvillimin e qytetarisë demokratike, duke furnizuar kështu deri kontingjente “fanatikësh” në një fushatë zgjedhore apo dhe shtresime “materialisht të manovrueshme” gjatë tyre. Pavarësisht se ku synon të mbështet më shumë njëra parti kryesore apo tjetra në fushatën e ardhshme zgjedhore, të dy projektionet e mësipërme janë me shenjë të qartë negative. Ata janë një kundërvënie ndaj prirjes së përgjithshme të zhvillimit politik, demokratik e shoqëror, madje janë divergjente me kërkesën-nevojë për rritje të pjesëmarrjes së ndërgjegjshme qytetare, që e shndërron përfundimisht qeverisjen nga “zotëruese” e “pronare” për gjithçka në thjesht shërbyese të qytetarit.

Për një tranzicion të mëtejshëm etiko-demokratik brenda partive shqiptare

Nga analiza e shumë parametrave, rezulton se Shqipëria po e mbyll fazën e parë kryesore të tranzicionit të saj, duke qenë në prag të proceseve integruese euro-atlantike. Por, ndërkohë, duhet përshpejtuar procesi i tranzicionit demokratik brenda vetë partive politike, sidomos i atyre parlamentare, për t’iu përgjigjur jo vetëm evolucionit të shoqërisë shqiptare, në shumë segmente të saj, por dhe detyrave të reja, e mbi të gjitha për të përballuar

sfidat e integritit. Vetëm kështu mund të transformohet më tej realiteti shqiptar jo më me demagogji, trysni e manipulime, por me ide, veprim e reformim edhe në rrafshin politiko-partiak, që detyrimisht do të gjejë pasqyrimin e tij në progresin demokratik-shoqëror e konsolidimin institucional. Vetëm kështu mund të rikthehet mbështetja dhe besimi në popull ndaj politikës, që në thelb kanë pësuar një tronditje jo të vogël, e shfaqur kjo masivisht edhe me një pakënaqësi e indiferentizëm kritik në rritje ndaj vetë politikës e pjesëmarrjes në zgjedhje.

Në këtë situatë, për demokratizimin e mëtejshëm të partive politike shqiptare, sidomos të atyre me anëtarësi më të madhe, po behet e domosdoshme që, në përfaqësimin e çdo niveli, partiak apo qeverisës, të mishërohet realisht parimi i ekuilibrit të forcave, që nënkupton dhe institucionalizimin e përfaqësimin e mendimit ndryshe, fraksioneve apo rrymave alternative në parti. Një element i rëndësishëm në administrimin e brendshëm të jetës së partisë është dhe funksionimi i plotë kolegjal i strukturave drejtuese të partisë si kundërvënie ndaj praktikës e teorisë së unitarizmit të drejtimit. Këto kërkesa lidhen dhe me thelbin e partisë si një bashkësi vullnetare e njerëzve të lirë e të barabartë, përndryshe do të mbahen larg dhe një pjesë e konsiderueshme intelektualësh, aq të nevojshëm për zhvillimin e mendimit politik të partisë dhe të alternativave të reja të tij. Një çështje tjetër, me përmbajtje krejtësisht etike, është dhe ajo e transparencës së profilit e programit të partisë dhe e strukturave të saj drejtuese. Aq e vërtetë është kjo sot në kushtet shqiptare saqë është mjaft e vështirë në shumë raste për grupimet politike kryesore për të përcaktuar krahun e tyre politik si: të majtë, të djathtë apo të qendrës. Në fakt, programi i partisë mund të ketë një divergjencë vetëm kohëshkurtër me atë të veprimit konkret politik apo qeverisës, por jo afatgjatë, sepse në fund të fundit kjo është dhe një çështje e etikës politike, e konsistencës dhe e moralitetit programor partiak para anëtarësisë dhe elektoratit përkatës. Dhe nëse kjo divergjencë po bëhet gjithnjë më e theksuar, në vitet e fundit, për PS-në, nuk mungojnë deklarata e propozime edhe nga PD-ja tërësisht të ndryshme nga programi e profile politik i saj. Po aq i rëndësishëm për demokratizimin e partisë është dhe thellimi i karakterit elektoral të saj. Krahas strukturimit

organizativo-elektoral të partisë, në periudhën midis zgjedhjeve veprimtaria e angazhimi kryesor i partisë nevojitet të përqendrohet në institucionet e përfaqësimit të saj, d.m.th., kryesisht në kuvend, këshilla qarqesh, bashkish e komunash, apo organet ekzekutive përkatëse qendrore e vendore, madje programi, ndihma e kualifikuar dhe mbikëqyrja e partisë duhet të përçohet kryesisht nëpërmjet përfaqësuesve të saj në këto institucione e organe. Por jo në çdo çast lloj lloje qëndrimesh e deklaratash të emetohen kryesisht nga selitë e partive!

Ndërsa, hapi më i rëndësishëm reformues në këtë kuadër është kalimi nga demokracia përpjesëtimore apo e delegimit në atë të drejtpërdrejtë, pra në një proces zgjedhor apo vendimmarrës me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të vetë anëtarësisë së partisë. Kjo demokraci e tipit “një anëtar, një votë” në kuptimin e vendimmarrjes, jo vetëm zgjeron hapësirat e demokracisë, por dhe rrit përgjegjësinë e rolin e drejtpërdrejtë të anëtarit të partisë. Parë në një plan shqiptar, krahas zbatimit të parimit “një anëtar, një votë”, për të shmangur dhe prirjet e shfaqura të autoritarizmit partiak, nevojitet dhe një “mbrojtje” tjetër demokratike që lidhet me kufizimin kohor të mandatit të kryetarit ose me përfshirjen në sistemin partiak të një procesi të rregullt rishikimi e analize etike-politike të udhëheqjes, së bashku me prerogativat përkatëse. Prandaj në sistemin rregullator apo statutin e partisë duhen konsideruar e trajtuar dhe disa formulime, që mund të përmbajnë kufizime statutove ndaj çdo prirjeje autoritare, arrogante apo egocentrike, që në fund të fundit e dëmton jo pak partinë, sidomos gjatë procesit elektoral.

Për një etikë normale në politikë

Problemi i etikës në politikën shqiptare, në thelbin e tij, duhet parë dhe në dy plane të tjerë: në planin “asketik” dhe atë “veçues”. Në një shikim të thjeshtëzuar, ky mund të “përkthehet” dhe si dallim midis politikanit e shtetarit “pa shpirt”, të sakrificës e punës dhe atij “me shpirt”, manipulues e qejfli. Por ka dhe një element tjetër, që mund të bëhet shqetësues dhe në kuadër të këtyre dy aspekteve të kundërta. Nën ndikimin e një formimi pa “tretje” të plotë, të një trashëgimie të kufizuar demokratike, të

besimit vetëm brenda rrethit (klanit) dhe mosbesimit jashtë tij, në një realitet shoqëror në lëvizje të vazhdueshme drejt lirisë e demokracisë, mund të shfaqet, siç ka ndodhur jo rrallë tek ne, dhe individit udhëheqës, që e shikon botën e shumëllojshme rrethuese, jo si reale, por provokuese e kërcënuese, të padrejtë e jo shpërblyese të “rolit” e “lojës”, më saktë të “manipulimit” e “shpikjeve”, të tij. Ai e percepton kështu gabimisht mjedisin fizik dhe shoqëror, ndaj të cilit ai reagon në mënyra të ndryshme, jo me konsistencë, deri në mënyrë kontradiktore, sipas problematikës vetjake, nevojave, hallit, “oreksit” apo “hesapeve” të tij, qoftë dhe nxitjeve të drejtpërdrejta ose të tërthorta të atyre që e rrethojnë dhe duan të përfitojnë. Dhe aq më keq, kur në këto “lexime” afërsia rrethuese shfaqet me përzgjedhje e “kompensime” nepotike e të padrejta nga pikëpamja politiko-institucionale, kurse “amiqësia” me kundërvënie të pa justifikuar, deri hakmarrje antiligjore. Prandaj si “disiplina” asketike, ashtu dhe ajo veçuese, me të mirat e të këqijat e tyre, në një kuadër më të gjerë kolektiv, duhet të përqendrohen në këtë rast në “shtypjen”, shmangien e kësaj sjelljeje e egoje “udhëheqësore”.

Përputhja e të dy aspekteve “disiplinore”, duke marrë vetëm pjesët pozitive të tyre, mund të ndihmojë në kushtet e sotme, për të zhvilluar disiplinën etike. Është kjo disiplinë etike, që i jep formë vetë etikës politike në përgjithësi. Ajo mundëson integrimin e premtimit me realizimin e tij, të fjalës së dhënë me veprën në terren, duke mishëruar një sjellje serioze e respektim të ligjit, konkurrim të ndershëm e tërheqje dinjitoze, etj. Në fund të fundit, etika politike lidhet ngushtësisht me vetë cilësinë e jetës politiko-shoqërore, me mënyrën se si duhet ndikuar, udhëhequr, zhvilluar e përjetuar ajo. Dhe kjo, ashtu si për qytetarin e thjeshtë, kur bëhet fjalë për një etikë të zakonshme ligjore e qytetare, vlen dhe për politikanin, udhëheqësin partiak, shtetarin e ish shtetarin, sidomos në funksion të kultivimit të etikës ligjore-kushtetuese e politike-institucionale. Një politikan e shtetar me etikë e integritet moral, në përputhje dhe me normat ligjore e shoqërore, me traditën, etj., duhet t’i thotë në mënyrë konstante vetes: “Unë duhet ta bëjë këtë. Kjo tjetra nuk duhet bërë!” Pikërisht kjo vetëçensurë, kjo “duhet” është baza e zakonshme njerëzore e moralit, që në thelb implikon dhe një luftë të përhershme për vetëpërmbajtje,

vetëgjykim e vetëkorigjim.

Ky është dhe problemi i sotëm, disa muaj para zgjedhjeve të përgjithshme, sepse, në fakt, në gjykimin qoftë të një “moraliteti” të shformuar të tipit thjesht “asketik” apo thjesht “veçues”, qoftë të një morali politik të vërtetë, tërësisht etik, nuk ka gjykatës specialë. Për më tepër, gjykimi, në të shumtën e rasteve, është më shumë imazh e perceptim. Ai është një shumë e komplikuar e gjykimeve individuale që formojnë vlerësimin kolektiv, partizan apo mbipartizan (shoqëror). Ky i fundit në situata të caktuara politike, siç është ajo që po afron, shprehet me anë të qëndrimit e votës qytetare.

Dhe pyetja përsëri mbetet po ajo e fillimit: si mund të adresohet kjo votë, kur ndodhesh në një “ngërç” të madh të besimit e mosbesimit, në kushtet e ekspozimit të një etike të dyfishtë politike, dhe për më tepër të një etike e jo etike, të alternuar qartësisht në kohë?! Kjo kërkon dhe një përgjigje prej gjithsecilit. Ndoshta, ka ardhur koha që të shihet në radhë të parë integriteti moral i kandidatit, niveli etik i sjelljes së tij qytetare e politike, niveli i angazhimit, shpirti i sakrificës e profesionalizmi i tij, dhe më tej, por shumë më pak, përkatësia konkrete partiake.

Garantimi i të drejtës së votës dhe numërimi i saj

Demokracia e sotme si institucion bazë të sistemit politik ka atë të votës së lirë e të barabartë. Vetë procesi i demokratizimit politiko-social, në thelbin e tij, përbën një lëvizje historike dhe të pandërprerë drejt shpërhapjes së fuqisë dhe zgjerimit përzgjedhës të “pushtetit qeverisës” prej një grupi të vogël njerëzish drejt një bashkësie gjithnjë e më të madhe. Kjo është konkretizuar tashmë në shumicën e vendeve të botës me barazimin e fuqisë së votës të gjithë individëve me moshë të dhënë, nëpërmjet ushtrimit të parimit “një njeri, një votë” në një sistem politik realisht pluralist e demokratik. Por fitimi i kësaj të drejte vote, nëpërmjet dhënies e garantimit të saj të gjithë qytetarëve (p.sh në Shqipëri me moshë votimi 18 vjeç e sipër), që teknikisht “përkthehet” si vendosje në listat e plota zgjedhore të gjithë votuesve, është vetëm njeri aspekt thelbësor i pluralizmit dhe demokratizimit politiko-shoqëror, kurse aspekti tjetër po aq i rëndësishëm është respektimi tërësor

i kësaj të drejte nëpërmjet numërimit korrekt të votës së hedhur e vlerësimit të drejtë të rezultatit. Pikërisht ky numërim e vlerësim i saktë ka qenë një shqetësim jo i vogël, krahas atij të zgjerimit të drejtës së votës, në procesin e zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Po aq i theksuar ka qenë ky shqetësim dhe në kushtet shqiptare.

Për të minimizuar, pra, gabimet, deri spekulimet me institucionin e votës, dy elementë qenësorë demokratikë duhet të jenë në qendër të vëmendjes për përgatitjen e mëtejshme të procesit të lirë e të ndershëm zgjedhor në zgjedhjet e ardhshme parlamentare: 1) respektimi e garantimi i të drejtë së votës që nënkupton lista të sakta votuesish dhe 2) numërimi korrekt e transparent i votës. Realisht, mund të konsiderohet një hap mjaft pozitiv fakti që numërimi është ligjëruar tashmë në nivel zone e jo në qendrën e votimit, që ai të zhvillohet në salla të mëdha, në prani, krahas anëtarëve të KZZ-së, të kandidatëve konkurrentë, të vëzhguesve partiakë apo të atyre kombëtarë e ndërkombëtarë, të gazetarëve e medias elektronike, etj.

Ndërkohë që ajo që do të kishte një vlerë të veçantë për kohën e mbetur mund të ishte arritja e një marrëveshje, në trajtën e një dokumenti politik apo dhe si shtesë ligji mbi “kodin etik” dhe “aktin elektorral”. Pikërisht në këtë kod mund e duhet të përmbahen një mori masash rregulluese që të mishërojnë parimet bazë etike gjatë procesit zgjedhor, por dhe pas tij. Midis tyre, për periudhën e fushatës zgjedhore dhe gjatë procesit të votimit, mund të përfshihen dhe ato elementë që lidhen me cilësinë e një fushate demokratike e qytetare, si p.sh me mënyrën e transmetimit të mesazheve zgjedhore e publike, të gjuhës së përdorur e sjelljes korrekte, të burimeve financiare të shfrytëzuar, të kërkesës për ndershmëri votimi e numërimi të votave ndaj anëtarësisë partiake, etj. Në kuadër të këtij kodi etik mund të përfshihet dhe akti elektorral, i lidhur ngushtë me fondet e fushatës. Sepse për ta ruajtur elementin etik në procesin zgjedhor është i nevojshëm dhe një system rregullator që përfshin mënyrën e financimit të fushatës, pra të gjitha donacionet apo burimet e tjera materiale, qoftë të partive politike apo të biznesit, qoftë të kandidatëve të veçantë.

Nëpërmjet këtij akti duhet të synohet dhe mundësisht të garantohet dhe barazia për një procesi zgjedhor të lirë e

të ndershëm. Po aty, normalisht, duhet të deklarohen dhe shpenzimet personale nga “xhepi” i kandidatit, për të cilat duhet të përcaktohet dhe limiti përkatës. Për të gjitha këto shpenzime duhet të garantohen dokumentet apo faturat përkatëse, që mund të verifikohen nga një strukturë e caktuar pranë KQZ-së, me kërkesë të një partive politike, apo dhe me ankesë të një kandidati të vetëm, të regjistruar pranë KQZ-së. Në këtë mënyrë krijohet dhe baza e nevojshme etike e ligjore për kthimin e besimit të qytetarit-votues mbi institucionin e votës, instrumentit të vetëm të ndërtimit të strukturave qeverisëse të shtetit demokratik. Por dhe etika mund të bëhet kështu gradualisht një element përbërës, më se normal, në politikën shqiptare, me rrezatim pozitiv në të gjitha strukturat e shoqërisë.

2. Ndershmëria në pjesëmarrje

Sue Nelson

Zgjedhjet nuk zhvillohen në boshllëk. Drejtuesit zgjedhor përcaktojnë kuadrin dhe proceset në bazë të së cilave kandidatët, votuesit dhe partitë politike marrin pjesë. Pjesëmarrja në zgjedhje është thelbësore për ndershmërinë e zgjedhjeve. Që procesi të jetë konkures partitë politike duhet të nxjerrin kandidatë. Kandidatët duhet të bëjnë fushatë dhe të shpallin platformat e tyre politike që të mund të fitojnë mbështetjen e votuesve. Grupet e interesit punojnë për të motivuar opinionin public për të mbështetur kandidatë apo çështje të caktuara. Votuesit marrin pjesë duke diskutuar çështjet politike, punën në fushatë dhe pjesëmarrjen në votim ditën e votimit. Pjesëmarrja në zgjedhje është një faktor i rëndësishëm për zgjedhjet demokratike dhe për të realizuar zgjedhje të lira, të drejta dhe të besueshme. Kjo pjesëmarrje duhet të realizohet me të njëjtën ndershmëri sikurse dhe administrimi i zgjedhjeve. Pjesëmarrësit kryesorë në një zgjedhje janë: partitë politike dhe kandidatët; grupet e interesit të cilat janë të interesuara të ndikojnë te rezultatet e zgjedhjeve; grupet e interesit të cilat kujdesen për interesat e publikut si dhe vetë votuesit.

Partitë politike dhe kandidatët

Partitë politike janë grupe të organizuara që konkurojnë në zgjedhje për të marrë pushtetin, drejtojnë qeverinë dhe përcaktojnë politikën publike. Struktura organizative e partive politike ndryshon sipas situatës politike dhe sociale të vendeve

të ndryshme por të gjitha ndajnë të njëjtat interesa përsa i përket nxjerrjes së kandidatëve dhe fitores së zgjedhjeve. Nisur nga ky interes, partitë politike mund të ndihmojnë për të ruajtur ndershmërinë duke monitoruar procesin zgjedhor për të siguruar që asnjë parti të mos ketë trajtime të diferencuara. Ata gjithashtu bëjnë publike çështjet politike, stimulojnë interesin për proceset politike, rekrutojnë kandidatët dhe zhvillojnë fushatat zgjedhore. Shumë sisteme elektorale lejojnë kandidatë të pavarur të kandidojnë pa mbështetjen e ndonjë partie. Kandidatët e pavarur dhe monitoruesit e tyre kryejnë të njëjtat funksione lidhur me integritetin sikurse dhe kandidatët nga partitë politike. Për të realizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, puna e brendshme e partisë politike duhet të jetë transparente dhe po aq e lirë dhe e drejtë sa vetë procesi zgjedhor. Kjo do të thotë që mekanizmat për përzgjedhjen e kandidatëve të jenë të drejtë, transparentë dhe përfshirës.

Udhëheqësit e partive politike mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre sipas rregulloreve të brendshme të partive si dhe të legjislacionit që përcakton aktivitetin e pjesëmarrësit. Partitë politike, në përpjekjet e tyre për të marrë pushtetin, jo gjithmonë kanë qenë modele të transparencës dhe ndershmërisë. Në SHBA psh disa organizata rajonale e lokale janë identifikuar si “makina politike”. Ky emër vjen nga partitë që funksionojnë si makina të vajisura mirë – të drejtuara nga një lider ose grup i vogël udhëheqësish autokrat urdhërat e të cilëve zbatohen nga një grup i vogël anëtarësh besnikë. Këto “makina” njihen për metodat e tyre joetike të mbajtjes së posteve të tyre të zgjedhura, të tilla si: rryshfetet, hatëret, korrupsionet, kontrolli i emërimeve dhe manipulimi i zgjedhjeve. Fuqia e këtyre makinave politike u reduktua me anë të prezantimit të zgjedhjeve të brendshme në parti për të zgjedhur një kandidat të partisë dhe aktivizimit të qytetarëve për të vendosur një qeveri të pastër dhe të përgjegjshme. Një parti politike që vepron në një mënyrë etike dhe të ligjshme gjatë procesit elektorale është një mekanizëm i ndershëm për zgjedhje efektive. Ajo mund të zvogëlojë përpjekjet për manipulimin e procesit dhe mund të ndihmojë për të siguruar përgjegjshmërinë e administratorëve zgjedhorë dhe pjesëmarrësve të tjerë. Në përgjithësi integriteti në pjesëmarrjen e partisë politike përfshin.

Përzgjedhje e hapur dhe e drejtë e kandidatëve

Një nga synimet kryesore të partisë politike është të zgjedhë kandidatët dhe t'i ndihmojë ata për të fituar. Për qëllim të ruajtjes së integritetit zgjedhor, kandidati i përzgjedhur duhet të jetë kandidati me mbështetjen më të gjerë popullore në parti. Në disa sisteme udhëheqësit e partisë politike ose një klikë e vogël brenda partisë i përzgjedh të emëruarit e tyre. I përzgjedhuri kështu i është borxhli udhëheqësve të cilët më pas presin favore dhe trajtime të tjera preferenciale. E njëjta gjë mund të jetë e vërtetë edhe për donatorët e mëdhenj të partive të cilët mund të përpiqen të blejnë kandidatët. Një nga mënyrat për të patur një përzgjedhje të hapur të kandidatëve është zgjedhja e tyre. Në SHBA, psh, forca e udhëheqësve të partisë u dobësua me anë të prezantimit të zgjedhjeve “primare”, të cilat hapën procesin e kandidimit dhe e bënë përzgjedhjen e kandidatit më përfaqësuese dhe demokratike.

Mbledhja e partisë është një mekanizëm tjeër për të përzgjedhur kandidatët e partisë. Ajo mund të bëhet vetëm me udhëheqësit e partive ose mund të përfshijë anëtarët e thjeshtë të partisë. Probleme të ndershmerisë që dalin nëse përdoret një mbledhje përfshijnë natyrën e tyre të parashikueshme, mungesën e një ndarje të pushtetit brenda partisë, përdorimin e marrëveshjeve sekrete ose shkëmbimi i favoreve për të manipuluar mbledhjen si dhe përdorimi i një mbledhjeje “snap” me anë të të cilës klika të vogla kontrollojnë procesin e kandidimit duke mos lajmëruar të gjithë pjesëmarrësit për mbledhje. Ajo mund të sjellë kompromise midis faktorëve të partisë dhe të kushtojë më pak duke e bërë procesin më ekonomik dhe të përbalueshëm për disa parti.

Organizimi i një fushate të pastër zgjedhore

Partitë politike dhe kandidatët marrin pjesë në një zgjedhje duke organizuar një fushatë që të mund të bindin votuesit e për të votuar për ta në ditën e votimeve. Disa nga çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin e një mjedisi të favorshëm për një fushatë të lirë dhe të drejtë. Zhvillimi i një fushate të pastër i ndihmon partitë të ruajnë integritetin e tyre dhe atë të procesit zgjedhor. Një fushatë e pastër do të thotë që ata të marrin pjesë me ndershmeri, të bëjnë fushatë për problemet dhe të zbatojnë rregullat e fushatës. Megjithatë konkurrenca zgjedhore supozohet të jetë një proces

paqësor, fushatat hartohen në mënyrë të tillë që të motivojnë zgjedhësit dhe t'i ndihmojnë ata të lidhin kandidatët me çështje apo emocione të veçanta. Meqë asnjë nuk është i sigurt nëse votuesit do të votojnë pro apo kundër kandidatëve, ata shpesh mbështeten në metodat e sulmit. Ata mund të përqendrohen në të metat e kandidatëve të tjerë duke theksuar pse sipas tyre që një person i caktuar nuk është i aftë të drejtojë. Shpesh kjo përqendrohet në jetën dhe cilësitë personale të kandidatit tjetër por nuk atakohet pozita politike.

Etika e fushatës

Fushatat janë ngjarje ku votuesit marrin informacione për partitë politike, kandidatët e tyre si dhe platformat e tyre politike. Votuesit e përdorin këtë informacion për të bërë përzgjedhjen midis konkuresve e midis partive në ditën e votimit.

Që votuesit të bëjnë një zgjedhje kombëtare dhe të informuar kanë nevojë për informacion të qartë dhe të saktë për kandidatin, programin dhe çështjet e përfshira në të. Ata duhet të jenë në gjendje të marrin vendime se për kë do të votojnë në një mjedis të sigurt, të lirë nga frika dhe kërcënimet. Integriteti e pëson kur votuesit nuk janë në gjendje të marrin pjesë në një miting elektoral ose të mbështetin hapur një parti politike ose kandidatët sepse ata kërcënohen nga mbështetësit e një partie tjetër politike. Kandidatët dhe partia politike që fitojnë zgjedhjet kanë nevojë për mbështetjen e votuesve. Integriteti kërkon që ata të jenë në gjendje të transmetojnë mesazhin e tyre pa ndërhyrje dhe pa pasur nevojë të përdorin taktika shpifëse apo forcë. Etika e fushatës dhe sjellja e partive dhe e mbështetësve të tyre ka një ndikim direkt në integritetin e procesit zgjedhor. Sjelljet joetike fushatore ose trajtime që ndikojnë në mënyrë artificiale rezultatin e zgjedhjeve dhe procesin nuk krijojnë mundësi për zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të besueshme. Për të siguruar integritetin në fushatën elektorale shumë sisteme zgjedhore kërkojnë që fushata të zhvillohet:

- Sipas rregullave dhe rregulloreve të vendosura në kuadrin ligjor;
- Pa shtrëngime dhe blerje votash;
- Duke respektuar kalendarin e zgjedhjeve;
- Duke respektuar të drejtat dhe lirinë e partive të tjera për t'u organizuar, për të zhvilluar fushatë dhe për të shkuar me

mesazhin e tyre tek votuesit;

- Duke respektuar të drejtën e votuesve për t'u informuar nga një larmi burimesh dhe për të marrë pjesë në mitingjet politike të partive të tjera;
- Nga pikpamja etike, duke u mbështetur në çështjet politike dhe platformat e kandidatëve dhe të mos zhvillojnë fushata fyese ose të mbushura me thashetheme dhe insinuata;
- Pa përdorimin e forcës, pa kërcënime ndaj kandidatëve të partive kundërshtarë, mbështetësve të opozitës apo medias dhe pa përdorur fjalë që mund të nxisë mbështetësit e tyre për dhunë;
- Duke respektuar lirinë e shtypit për të pasqyruar fushatën dhe për të shprehur opinionet për fushatën;
- Duke respektuar menaxherët e fushatës elektorale dhe duke mos ndërhyrë në realizimin e detyrave të tyre;
- Duke përdorur proceset e ankesave zyrtare dhe sistemet ligjore për apelim;
- Duke pranuar dhe përmbushur rezultatet zyrtare të zgjedhjeve dhe vendimin përfundimtar të zgjedhjeve të shpallur nga organet përkatëse.

Kodet e sjelljes për partitë politike

Disa sisteme zgjedhore përdorin një kod sjelljeje për të rregulluar sjelljen e partive politike, kandidatëve dhe mbështetësve të tyre përgjatë zgjedhjeve. Këto mund të jenë marrëveshje vullnetare që vijnë nga një konsensus midis partive ose ato mund të jenë pjesë e kuadrit ligjor dhe rregullores në fuqi. Kodet e sjelljeve duhet të adoptohen sipas kushteve të veçanta të secilit sistem zgjedhor. Në demokracitë më të vjetra, në të cilat financimi i fushatave është problem kodet etike përfshijnë instruksione të hollësishme për atë që është ose nuk është e lejuar në financimin e fushatës. Në vendet në tranzicion, vëmendja e kodit të sjelljes përqendrohet kryesisht në mënjanimin e dhunës dhe në marrëveshjen për të pranuar rezultatet e votimit. Kodet e sjelljes për partitë politike përfshijnë partitë, kandidatët e tyre si dhe mbështetësit. Disa kode u kërkojnë partive të kontrollojnë aktivitetet e mbështetësve të tyre dhe të mbajnë përgjegjësi në rast shkeljeje të kodit nga mbështetësit e tyre.

Financimi i fushatës

Konkurimi në një zgjedhje kushton dhe fushatat elektorale po bëhen gjithnjë e më të kushtueshme. Nevojiten fonde për të ngritur një zyrë për fushatën, për të paguar stafin, për të bërë sondazhe, për të transmetuar mesazhin e fushatës tek votuesit dhe për kandidatin që të udhëtojë për të takuar votuesit.

Probleme të integritetit në financimin e fushatave

Duke u nisur nga fakti se zgjedhjet po kushtojnë kaq shumë si dhe nga fakti që sipas studimeve fituesit harxhojnë më shumë, mund të ndodhë që partitë politike dhe kandidatët të zhyten në problemet e grumbullimit të fondeve. Mënyra sesi financohen fushatat dhe çfarë bëjnë partitë dhe kandidatët me këtë financime mund të jetë burim për shumë probleme që lidhen me paprekshmërinë e figurës. Sipas Michael Pinto-Duschinsky “korrupsioni dhe abuzimet që lidhen me financimin e zgjedhjeve dhe të partive politike janë rreziqet më të zakonshme me të cilat përballen demokracitë sot”. Këto rreziqe mund të përfshijnë trajtime preferenciale të kontribuesve të mëdhenj. Donacionet e mëdha të bëra nga individë të pasur dhe grupe të veçanta të interesit mund të krijojnë shpërpjestime të mëdha në ndikim.

Edhe në rastet kur nuk bëhen lidhje të tilla me një donacion, pranimi i donacioneve të mëdha nënkupton blerjen e ndikimeve dhe trajtimeve speciale, pra krijohet ideja se zgjedhjet mund të konkurohen nga individë të pasur ose nga individë me miq dhe mbështetës të pasur – dhe se ata që nuk mund të mbledhin para të mjaftueshme nuk mund të konkurojnë. Ky perceptim kohët e fundit u përforcua nga tërheqja e Elizabeth Dole nga gara presidenciale Republikane e SHBA sepse ajo nuk ia doli mbanë të grumbullonte para të mjaftueshme të vazhdonte fushatën e saj deri në fazën përfundimtare. Sipas Common Cause një grup i interesave publike amerikane i cili bën lobim për qeveri të përgjegjshme dhe zgjedhje të pastra: Mënyra sesi financohen sot fushatat për Kongresin Amerikan është e korruptuar. Ky është një sistem ku individë dhe grupe mund të kontribuojnë shuma t’u konsiderueshme zyrtarëve të zgjedhur që kanë pushtet për të marrë vendime që ndikojnë në interesat e këtyre donatorëve. Ky gjithashtu është një sistem ku avantazhet financiare të titullarëve

çojnë në zgjedhje jokonkurrese duke i bërë ata më pak përgjegjës ndaj votuesve dhe më përgjegjës ndaj kontribuesve me interesa të veçanta.

Rregulli i financimit të fushatës

Shumë sisteme zgjedhore përpiqen të kufizojnë ndikimin e parave dhe influencën e donatorëve të mëdhenj me anë të rregulloreve për shpenzimet dhe financimet e fushatës dhe duke dhënë fonde publike për qëllime fushatash. Rregullimi i asistencës për fushatën politike si në formën kur ofrohet kohë dhe punë vullnetare për të ndihmuara një kandidat të favorizuar ose kur dhurohen fonde dhe burime mund të jetë i ndjeshëm sepse prek çështje të tilla si liria e fjalës dhe e shtypit. Shumica e sistemeve zgjedhore e kanë shmangur rregullimin e të drejtës themelore të një votuesi ose të një grupi për të mbështetur kandidatin e tyre të zgjedhur. Në vend të saj ata përqendrohen në transparencën e proceseve financiare – duke kërkuar një deklaram maksimal publik të të gjitha dhurimeve dhe shpenzimeve. Ligjet e financave të fushatave kërkojnë një proces të rregullt raportimi dhe ndonjëherë mund të kufizojnë sasinë e fondeve që mund të mblidhen apo mund të shpenzohen. Në SHBA, psh, janë aprovuar një nr ligjesh për të rregulluar shpenzimet e fushatës federale. Një nga këto është akti i Fushatës Zgjedhore Federale që krijoi Komisionin Zgjedhor Federal për të siguruar që kandidatët në zgjedhjet federale nuk duhet të ishin të detyruar ndaj një grupi të vogël njerëzish. Shpresohet që ligji do të mbështeste dhe nxiste besimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen e tyre në procese demokratike. Kongresi e nxori këtë ligj sepse besonte se forma përfaqësuese e qeverisë kishte nevojë për t’u mbrojtur ndaj influencave gërryese të donacioneve politike të pakufishme e të padeklaruara”.

Kufizimi i shpenzimeve zgjedhore

Disa sisteme e kufizojnë sasinë e parave që mund të shpenzohet në një zgjedhje. Në Zelandën e Re, ligji kërkon që një parti që konkuron në zgjedhje të mos e kalojë shumën prej 1 milionë \$ plus 20 000 \$ për secilin kandidat të zonës elektorale

të caktuar nga partia në periudhën 3 mujore parazgjedhore. Në rastin e Nepalit, si rezultat i vështirëve për të deklaruar shpenzimet aktuale nga partitë politike, po punohet për të ulur nivelin e shpenzimeve elektorale. Për të reduktuar kostot dhe për ta bërë garën më të përballueshme janë vendosur kufizime në kohëzgjatjen e fushatës elektorale, në materialet e fushatës që do të përdoren, në përmasat dhe numrin e posterave që mund të shpërndahen. Nëse shpenzimet e fushatës kufizohen së tepërmi apo shpenzimet e zgjedhjeve përballohen nga shteti dhe nëse votuesit janë të edukuar dhe partitë politike përzgjedhin si kandidatë persona popullorë, fushatat elektorale do të jenë më pak të përligjura dhe zgjedhjet konkurruese nuk do të jenë shumë të kushtueshme. Njerëz të aftë, të ndershëm, të sinqertë, me më pak burime financiare mund të fitojnë zgjedhjet dhe cilësia e legjislativit pa dyshim do të përmirësohet si rezultat i pastërtisë së figurës dhe nderëshmërisë së anëtarëve të zgjedhur në shekullin 21.

Kufizimi i kontributeve për fushatat elektorale

Përveç kufizimit të shpenzimeve, shumë sisteme përcaktojnë gjithashtu se kush mund të kontribuojë në fushatat politike si dhe sa mund të kontribuojë. Këto kufizime në para të dhëna direkt për të mbështetur një kandidat mund të përfshijnë: Kufizimi i donacioneve vetëm për shtetasit ose qytetarët me status rezidencial të përhershëm. Në Kanada p.sh. partitë politike dhe kandidati mund të marrin donacione vetëm nga shtetas Kanadezë ose nga rezidentë të përhershëm. Korporata ose shoqata që nuk zhvillojnë biznesin e tyre në Kanada nuk mund të kontribuojnë. Po kështu mund të kontribuojnë edhe parti politike ose qeveri të huaja si dhe sindikata që nuk gëzojnë të drejtat e kodit Kanadez.

Në SHBA, kontributet dhe shpenzimet politike nga kombe të huaja. Në termin “komb i huaj” përfshihen një qeveri e huaj, parti politike e huaj, korporatë e huaj, organizatë e huaj, partneritet i huaj, individë me shtetësi të huaj dhe emigrantë të cilët nuk kanë kartë rezidence. Një shembull i tillë janë ligjet elektorale të SHBA të cilat kufizojnë donacionet nga korporatat, organizatat e punës dhe përfaqësues të qeverisë federale. Megjithatë, ky grup mund të krijojë një “komitet veprimi politik” i cili mund të mbledhë kontribute vullnetare nga një grup i caktuar individësh dhe të përdorë këto fonde për të mbështetur kandidatët federalë dhe

komitetet politike duke kufizuar sasinë e dhurimeve të bëra nga një grup apo individ. Kjo shumë varion për sisteme të ndryshme.

Shpenzimet e pavarura të fushatës

Shpenzimet e pavarura të bëra nga një individ apo grup në emër të një fushate janë zakonisht të mbrojtura si pjesë e lirisë së fjalës dhe shtypit. Ky financim i njohur si “para të buta” është një mënyrë për kontribuesit e mëdhenj për të ndihmuar partinë, kandidatin e tyre apo çështje të tjera pa qenë të kufizuar nga financimet e kufizuara për fushatën sipas ligjeve financiare. Sipas Common Cause, “paratë e buta korruptojnë për një arsye të thjeshtë dhe të dukshme. Dhurimet e parave të buta jepen në shuma marramendëse si – \$50,000, \$100,000 apo më shumë dhe zakonisht këta dhurues presin të marrin një lloj shpërblimi për këtë investim”.

Në vjeshtë të 1999, Common Cause i kërkoi kandidatëve për presidentë që në garën presidenciale të vitit 2000 të nënshkruanin një kontratë “për mos dhunimin e ligjit financiar federal për fushatën duke hequr dorë nga financimet e padukshme të parave të buta. Pjesë nga kjo kontratë konsistonin në: “Unë betohem publikisht t’i bindem ligjeve financiare federale për fushatën duke pranuar që as unë, as agjentët e mi, nuk do të përdorin asnjë palë të tretë – të tilla si PAC nivel shtetëror, fondacione jofitimprurëse ose korporata për të mbledhur dhe shpenzuar para të buta për të promovuar kandidaturën time për President të SHBA”. Asnjë prej kandidatëve për President nuk e nënshkroi kontratën dhe që të dy si Guvernatori Bush (republikan) dhe zëvendës presidenti Gore (demokrat) vazhduan të mbledhin sasira rekord parash të buta për të mbështetur fushatat e tyre.

Kërkesat për deklarin publik

Shumë prej sistemeve zgjedhore kërkojnë një deklarin publik të financave të fushatës në mënyrë që votuesi të dijë se kush po e mbështet financiarisht kandidatin dhe nëse kjo mund të influencojë vendimet e tij me ardhjen në pushtet pas fitores së zgjedhjeve. Ky deklarin publik i financave zakonisht bëhet nëpërmjet raportimit periodik prej kandidatëve, partive politike, komiteteve të veprimtarive politike dhe lobistëve. Këto raporte pasqyrojnë

sasinë e fondeve të mbledhura dhe të atyre të shpenzuara. Në raport duhet të pasqyrohet informacioni i mjaftueshëm në mënyrë që autoritetet të përcaktojnë nëse ligjet financiare të fushatës janë respektuar dhe në mënyrë që votuesit të dinë se kush po e mbështet financiarisht kandidatin. Raportet e deklaruar zakonisht lihen në dispozicion të publikut dhe monitorohen nga afër nga organizata jo qeveritare.

Zbatimi i ligjeve financiare të një fushate elektrorale

Zakonisht, një sistem i besueshëm dhe efektiv zbatues është një pjesë integrale e paketës rregullatore të fushatës për t'u siguruar që ligjet e saj janë respektuar. Kjo është e nevojshme, sepse siç shprehet dhe Michael Pinto-Duschinsky, "kur bëhet fjalë për fitime të mëdha dhe politikanë të zgjuar e ambiciozë janë në konkurrencë me njëri-tjetrin, do të ketë gjithnjë përpjekje, shpesh të suksesshme për ta shmangur ligjin apo qëllimet e tij". Për të ruajtur paanësinë e një procesi elektorale dhe integritetin e sistemit financiar të fushatës, ngritja e mekanizmave imponues dhe rregulloreve të mirëpërcaktuara është thelbësore.

Shumë sisteme e delegojnë përgjegjësinë e zbatimit tek forca e tyre drejtuese politike elektorale ose tek institucione të specializuara. Një zbatim i mirë kërkon burime njerëzore, fonde të mjaftueshme dhe sanksionet e duhura penale. Në Brazil, psh, janë ndërrmarë seanca gjyqësore por nuk ka sanksione ligjore apo limite financimi. Gjykata zgjedhore ka fuqinë vetëm të verifikojë informacionin e servitur nga partitë politike duke bërë një rishikim administrativ të raporteve për të përcaktuar përputhjen e parimeve financiare të vendosura dhe klauzolave të përgjithshme të ligjit për financat e fushatës. Nëse raporti financiar nuk pranohet nuk ekzistojnë sanksione të vendosura për kandidatin apo kualifikimin e tyre për konkurim. Në SHBA, nga ana tjetër, Komisioni Zgjedhor Federal (FEC) ka një juridiksion ekskluziv mbi zbatimin civil të ligjit financiar federal të zgjedhjeve.

Nëse shqyrimi i një raporti të deklaruar i bërë nga FEC, apo ndonjë ankese e bërë nga qytetarët evidenton ndonjë dhunim, atëherë komisionerët do të autorizojnë një Investigim. Nëse investigimi konfirmon ekzistencën e ndonjë dhunimi atëherë FEC përpiqet të arrinjë në një marrëveshje me përgjegjësit. Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet FEC mund të denoncojë kundra personave përgjegjës në gjykatë. Në Kanada, zbatimi i

ligjeve financiare të fushatës elektorale imponohet nëpërmjet Komisionerit të Zgjedhjeve Kanadeze. Shkelja e ligjit evidentohet nëpërmjet raporteve të auditimit. Dënimet mund të konsistojnë në gjoba, burgim, humbje të së drejtës për të votuar apo për t'u zgjedhur në zgjedhjet federale për një periudhë 5 vjeçare.

Financimi publik i fushatave elektorale

Për të kundërshtuar varësinë e kandidatëve ndaj donatorëve të fuqishëm, dhe për të barazuar në fushën e lojës, disa sisteme ofrojnë financim publik për fushatat elektorale. Me qëllim forcimin e besimit dhe rritjen e efektivitetit gjendet dhe përdoret një formulë e paanshme për ndarjen e fondeve ndërmjet kandidatëve konkurrentë. Përfituesit janë përgjegjës për përdorimin e fondeve ashtu siç është parashikuar dhe zakonisht duhet të paraqesin raporte financiare pas përfundimit të zgjedhjeve.

Kriteret kualifikues janë një ndihmë e barabartë dhe e arsyeshme për të siguruar integritetin e një programi financues publik dhe ndihmojnë për të shmangur situata të tilla ku një kandidat apo parti mund të marrë një sasi të madhe fondesh, ndërsa të tjerat fare pak ose aspak. Një mënyrë për t'u siguruar se kriteret e aplikuara janë të drejta është diskutimi i tyre i hapur publik përpara se ato të zbatohen. Kjo mënyrë mund të përdoret gjithashtu për t'u siguruar se formula e zgjedhur për ndarjen e fondeve ndërmjet partive të kualifikuara është e drejtë. Çdo sistem ka rregullore dhe kufizimet e veta për përdorimin e fondeve publike. Një kufizim i zakonshëm është përdorimi i fondeve vetëm për blerjen e kohës së transmetimit (shiko shtojcën mbi aksesin në media). Mund të ketë gjithashtu kufizime për sasinë e fondeve private që mund të pranohen nga kandidatë dhe parti nëse ata kanë pranuar të marrin financim publik. Kufizimet e logjikshme të cilat kuptohen lehtë dhe aplikohen me paanësi mund të ndihmojnë në ruajtjen e integritetit në përdorimin e fondeve publike.

Shpenzimet e paligjshme të fushatës

Ka disa përdorime të financimit publik të fushatës të cilat janë të paligjshme pothuajse në çdo lloj sistemi. Këtu përfshihen: Blerja e votes. Blerja e votave apo oferta financiare apo materiale në shkëmbim të marrjes së votës është element i paligjshëm dhe joetik. Këtu përfshihet të blerit e abstinimit apo pagesa e votuesve

për të ndenjtur në shtëpi. Për shembull në SHBA, 30 nga 50 shtete e dënojnë këtë akt të barabartë me krimin e “korrupsionit”. Në Meksikë, blerja e votës përfshin pagesat për organizimin dhe transportin e votuesve drejt kutive të votimit me qëllim influencimin e zgjedhjeve të tyre politike.

Korruptimi i zyrtarëve. Një sondazh mbi këto aspekte të korrupsionit i ndërmarrë në 1999 prej “Transparency International” evidentoi se 33% e përgjigjeve pasqyronin ndjesi të rritjes së korrupsionit. Korrupsioni përfshin dhurimin ilegal të parave apo të diçkaje tjetër me vlerë në shkëmbim të një shërbimi apo trajtimi favorizues. Këto lloj manipulimesh janë të jashtëligjshme në pothuajse çdo sistem zgjedhor.

Në një fushatë zgjedhore, fondet financiare apo sendet me vlerë nuk duhet të përdoren si përpjekje për të blerë një kartë regjistrimi për votuesit, për të blerë regjistrimin e një kandidati apo për të inkurajuar manipulimin e rezultateve zgjedhore. Paratë nuk duhet të përdoren për të paguar monitoruesit zyrtarë apo policinë për të marrë një krah tjetër. Pagesat e veçanta janë gjithashtu një formë tjetër manipulimi. Përdorimi i këtyre pagesave për të siguruar kontrata në lidhje me zgjedhjet është veprim joetik dhe i paligjshëm. Këto lloj pagesash rrisin koston e mjeteve dhe materialeve të zgjedhjeve dhe mund të rezultojë në blerjen e shumë sendeve të panevojshme dhe jo me standartet e duhura. Manipulimi ose destabilizimi i procesit zgjedhor. Përdorimi i fondeve të fushatës për të promovuar dhunën, punësuar banda apo kryer vepra të dhunshme gjatë procesit zgjedhor apo kundrejt kandidatëve, partive ose votuesve është veprim i paligjshëm në çfarëdo lloj sistemi. Fondet e fushatës nuk duhet të përdoren për të krijuar lista false të regjistrimit të votuesve apo stacione votimi inekzistente. Nuk duhet të përdoren absolutisht për shkatërrimin e materialeve zgjedhore apo për të kërcënuar e terrorizuar zyrtarët zgjedhorë.

Fragmetet janë përdorur me lejen dashamirëse të Projektit ACE (www.aceproject.org; Copyright 1998-2003. IFES, UN-DESA, IDEA)

3. Politika e llogoreve e ka mbaruar kohën e saj

Preç Zogaj

“Me dënue lipset më pak elekuencë se sa më falë” - kjo sentencë lapidare e Hobsit, një filozof dhe politolog i shquar anglez që nuk shquhet për ndjenja pudori, evidenton një shkak të gjithkohshëm, sigurisht jo të vetmin, të konfliktualitetit, intolerancës apo dhunës verbale në politikë. Shkaku është mungesa e kulturës, kultura e pamjaftueshme ose prapambetja relative kulturore në një kohë të caktuar. Në funksion të kësaj analize, shprehjen e mësipërmje mund ta themi: “me dënue lipset më pak kulturë se me falë”. Dhe të marrim, pak a shumë të njëjtin kuptim si në shprehjen origjinale të Hobsit. Edhe në politikën shqiptare, problemet e konfliktualitetit, pavarësisht si shfaqen e si argumentohen, janë në thelb probleme kulturore. Regjimi komunist kultivoi për një gjysëm shekulli standartet e insultimit, marginalizimit, përjashtimit dhe eliminimit të së ndryshmes në politikë. Në përputhje me këto standarte mori jetë edhe një fjalor, një mënyrë shprehjeje, një stil i caktuar sjelljeje ndaj Tjetrës, ndaj së Ndryshmes, ndaj Kundërshtares. Literatura politike, por edhe ajo artistike edukonte dhe kodifikonte një etikë - le ta quajmë kështu - sipas së cilës gjithçka jashtë doktrinës apo jashtë nomenklaturës zyrtare të vlerave meriton vetëm përçmim, epitet dhe flakje.

Nuk ka dyshim se kjo trashëgimni la gjurmë në formimin e popullit që u rrit në rregjimin komunist dhe nuk mund të mos shoqëronte tranzicionin e vendit nga shoqëria e mbyllur komuniste në shoqërinë e hapur demokratike. Qysh në zgjedhjet e para pluraliste të marsit të vitit 1991 u vu re fakti se në mjaft

ballafaqime elektorale mes kandidatëve të Partia Socialiste dhe Partisë Demokratike të sapoformuar vendin e argumenteve mbi idetë e zhvillimit e zinte jeta apo biografia private e kandidatit. Pra nuk garohej rreth pyetjes “çfarë propozon”, por “kush propozon”, që do të thoshte se kandidatët në fjalë nuk ishin çliruar nga manteli i traditës, madje, në planin etik nuk dinin të silleshin ndryshe veçse si nxënës të literaturës së vjetër. Për fat të keq këto shenja apo tendenca do të vinin duke u forcuar në vitet e mëvonshme. Shpeshherë fushatat elektorale në Shqipëri kanë kaluar si manifestime të dhunës verbale dhe politikës së llogoreve, ku palët luajnë në distance “për jetë a vdekje”. Apo siç thuhet në gjuhën e lojrave të fatit palët luajnë në programin “non zero sum game”, që do të thotë se për të mundurin nuk ka alternativë veçse të largohet.

Natyrisht, jeta politike dhe fushatat elektorale të këtyre katërmbëdhjetë vjetëve në Shqipëri kanë njohur edhe periudha paqeje apo momente moderacioni. Bëhet fjalë për zhvillime që janë diktuar ose nga teprimi me konfliktualitetin, pra palët kundërshtarë kanë ndjerë nevojën e një armëpushimi, ose janë diktuar nga faktori ndërkombëtar që ka dashur të ekperimentojë me kandidatët e ndryshëm ballafaqime të tipit perëndimor, duke u udhëhequr nga ideja se dialogu në vetvete i zvogëlon problemet, kurse distanca vetëm i zmadhon ato. Në këtë aspekt, kronologjia e zhvillimeve paraqet thyerje të panatyrshme dhe nuk na lejon të flasim për një kurbë etike që shkon gjithnjë drejt normalizimit. Kështu, për shembull, në zgjedhjet vendore të vitit 2000, OSBE aplikoi një program të ballafaqimit televiziv të kandidatëve kryesorë për kryetarë bashkish. Ato ballafaqime patën një ndikim pozitiv në modelimin e një fushate që prirrej nga përmbajtja e programeve. Por tre vjet më vonë, në zgjedhjet e reja vendore, zgjedhësit e Tiranës, për shembull, u privuan nga mundësia për të parë një debat mes kandidatëve rivalë për arsye se kandidati socialist e refuzoi një debat të tillë. Kësisoj, fushata në fjalë u kthye pjesërisht në llogoret e vjetra dhe vakuumin e debatit rreth temave të programit e “mbushën” batutat e kandidatit që kishte refuzuar debatin, duke ndikuar kështu në ngritjen e tensioneve dhe, për pasojë, edhe në dëmtimin thelbësor të atyre zgjedhjeve.

Dialogu apo paqja politike në Shqipëri ka njohur si kulm të ashtuquajturën marrëveshje Nano-Berisha në qershor të vitit

2002, marrëveshje e cila, ndërsa çoi në zgjedhjen e Presidentit konsensual të Republikës, eksperimentoi edhe një marrëdhënie politike të re midis qeverisë dhe opozitës. Prishja e kësaj marrëveshjeje në fillim të vitit 2004 erdhi si rezultat i përdorimit të ndihmave humanitare (miell) nga pala socialiste në zgjedhjet e perseritura në zonën 52 të qytetit të Elbasanit. Në të vertetë, zgjedhjet në atë zonë ishin si pika e ujit në gotë e mbushur, por arsytet e prishjet se marrëveshjes Nano-Berisha ishin me të thella. Është kuptuar tashmë se marrëdhënien e tyre si krerë të dy partive kryesore, për rrjedhim, natyrën e pluralizmit në Shqipëri e ndikojnë faktorë të ndryshëm që lidhen sa me mënyrën e qeverisjes, aq edhe me traditën, apo me gjeopolitikën në rajon e me gjerë. Por duke qëndruar brënda argumentit, do thoshnim se problemet e dialogut politik në Shqipëri lidhen me faktin se palët, shpeshherë kanë qenë më shumë të ngjashme se sa të ndryshme, përse u përket programeve. Pra ato janë detyruar që edhe ta simulojnë ndyshimin, duke e zhvendosur fokusin e përbaljes nga programet të çështjet private apo të personat. Është dashur të kalojnë vitet dhe të grumbullohet një përvojë origjinale që të reflektohet në mënyrë konstruktive rreth faktit se pluralizmi i vërtetë e lehtëson dialogun dhe mirëkuptimin, ndërkohë që simulimi i tij shoqërohet pashmangshëm me tensione. Normalisht, pritet që duke reflektuar mbi përvojën e mbledhur si dhe rreth nevojave të shoqërisë, aktorët kryesorë politikë të ndryshojnë për mirë në fushatën e afërt elektorale. Por nuk duket të ketë asimetri në këtë lloj reflektimi dhe prandaj tabloja, nuk paraqitet shumë optimiste. Nga një anë opozita dhe shefi i saj, zoti Sali Berisha, po përpiqen të orientohen nga programet e reja të zhvillimit duke paralajmëruar një fushatë që do t'i përkushtohet tërësisht së ardhmes. Prej tre muajsh, Komiteti i Orientimit të Politikave pranë Partisë Demokratike pasqyron çdo të dielë pjesë të projektprogramit.

Duke komentuar këto prurje, kreu i qeverisë po flet gjithnjë e më shpesh për “terapi vdekjeprurëse të opozitës”, për “rikthim të falangave të vitit 1997” e tjerë. Edhe sllogani elektorale i paralajmëruar nga socialistët- “të mbrojmë të ardhmen”- përcjell një atmosferë konfrontimi dhe tradhëton inkoshientin e një kupole që nuk ndjen nevojën të zhvillojë ndonjë gjë, por thjesht të mbrojë pasuritë e vëna. I gjithë komportimi i kryemnistrit në këtë fazë është një ogur i keq dhe një përpjekje për ta nxjerrë fushatën

elektorale nga hullia e ndeshjes së alternativave, duke e projektuar si një luftë të pambaruar kurrë të vitit 1997. Opozita duket t'i shmanget këtij kurthi që synon sterilizimin e fushatës së saj. Më tej, opozita duhet të shmangë shprehjet, qoftë edhe sporadike apo emocionale të retorikës së kërcënimeve, që nuk kanë vend në fjalorin e demokracisë dhe që kundërshtari i përdor si alibi për të ngritur artificialisht tensionin. Klasa politike shqiptare, ka kohë të kuptojë se politika e llogoreve e ka mbaruar përfundimisht kohën e saj në Shqipëri.

4. Etika në fushatën zgjedhore

Petro Koçi

Të shkruash për kulturë dhe etikë në fushatat zgjedhore, nga pozita e politikanit, gjendesh përballë rrezikut të krijimit të perceptimit si hipokrit apo si predikues i tipit “bëni se them unë, mos bëni si bëj unë”. Sepse, pavarësisht nga fakti që jo e gjithë klasa politike aktuale është bashkëfajtoare në kërkeshjet e deritanishme elektorale, çdo politikan i përgjegjshëm duhet të ndjehet së paku bashkëpërgjegjës. Do ishte lumturi nëse ndjenja e bashkëpërgjegjësisë do verifikohet edhe të mbarë shoqëria shqiptare, si terreni i përshtatshëm kulturor dhe mendor ku bën përshesh politik konflikti, sherrnaja ballkanike, ngadhnjimi i shëmtuar, apo paturpësia publike.

Praktika shqiptare ka vërtetuar se zgjedhja e kompromentuar çon në ushtrim të korruptuar të përfaqësimit, në pushtet apo në opozitë ndodhtë! Morali i administrimit të procesit zgjedhor ka qenë shpesh faktori përcaktues i fituesit të zgjedhjeve.

Sporti i manipulimit të zgjedhjeve filloi me “ndeshjet” e balotazhit në zgjedhjet lokale 2 gusht 1992; u konsolidua në “spartakiadën” e Libofshës, 29 maj 1994; u shndërrua në sport masiv në “kampionatet kombëtare” të majit dhe tetorit 1996. Megjithë rënien, ky lloj sporti vazhdon të luhet aty-këtu midis skuadrave politike shqiptare.

Duke e lënë përdorimin e figuracionit duhet të pranojmë se fushatat zgjedhore në Shqipëri dominohen nga këto karakteristika:

1. Fryma antishtet. Ajo shfaqet me platformat dhe parrullat e marrjes apo mbajtjes së pushtetit me çdo kusht e me çdo

mjet, kjo frymë zbërthehet në variantin “shkatërro shtetin për të marrë pushtetin” apo në variantin “shpërdoro shtetin për të mbajtur pushtetin”.

2. Ndërtimi i besueshmërisë elektorale mbi rrënimin e imazhit të kundërshtarit. Fushatat elektorale në Shqipëri i karakterizon lufta e paprincipitë politike ndaj kundërshtarëve apo rivalëve. Ato shoqërohen me shpifje deri ordinere për të bindur zgjedhësit se kundërshtari nuk vlen dhe se duhet zgjedhur e keqja më e vogël. Fatkeqësisht platformat elektorale ose premtimet qeverisëse nuk arrijnë të ballafaqohen nëpërmjet argumentave dhe kulturës moderne politike.
3. Personalizimi i ballafaqimit politik. Kjo vjen nga filozofia e mbrapshtë e privatizimit të skenës politike dhe sundimi i urrejtjes në marrëdhëniet mes kundërshtarëve politikë. Përgjithësisht gara mes partive politike perceptohet si luftë Nano-Berisha apo luftë e ndonjë binomi tjetër.
4. Shndërrimi i garës politike në konflikt. Rivalitetin politik në Shqipëri e karakterizon papajtueshmëria dhe mungesa e marrëveshjeve apo konsensusit. Rastet e rralla të konsensusit janë arritur vetëm nën presionin demonstrativ të komunitetit ndërkombëtar.

Etika bashkëkohore e fushatës së zgjedhjeve është element thelbësor në integritetin e zgjedhjeve. Fushatat janë ngjarje ku votuesit marrin informacion për subjektet zgjedhore, kandidatët e tyre dhe platformat përkatëse qeverisëse. Votuesit e përdorin informacionin për të bërë zgjedhjen e duhur midis partive dhe kandidatëve rivalë në ditën e zgjedhjeve.

Që zgjedhësit të jenë në gjendje të bëjnë një zgjedhje të mençur dhe për arsye të informacionit të plotë, ata kanë nevojë për informacion të qartë dhe të saktë mbi përmbajtjen, cilësitë dhe platformat e kandidatëve. Kjo zgjedhje garantohet në një ambient ku ata të ndjehen të sigurtë, të çliruar nga ndjenja e frikës apo e kërcënimit. Integriteti i zgjedhjeve do të çënohej nëse dikush nuk ndjek dot mitingun e një partie politike apo dikush nuk mundet të shfaqë hapur simpatinë për një parti dhe kandidat të saj sepse ndjehet i kërcënuar nga përfaqësues të një partie tjetër politike.

Kandidati apo partia politike nuk mund të fitojë pa mbështetjen e votuesve. Që t’ia arrijnë kësaj, mesazhi i tyre duhet të mbërrijë të zgjedhësit për ndërhyrje, pa u cënuar nga dhuna apo taktika të liga.

Sjellja pa etikë në fushatë apo qasje zgjedhore që ndikojnë në mënyrë artificiale mbi rezultatin e zgjedhjeve, do të bënin që

procesi zgjedhor të mos jetë i besueshëm, i lirë dhe i ndershëm. Për të siguruar shëndet të procesit të fushatës zgjedhore duhet të udhëhiqemi nga këto parime:

- A. Respektim të plotë të rregullave dhe kërkesave të përcaktuara nga kuadri ligjor;
- B. Shmangja e blerjes së votave;
- C. Respektim i afateve në zbatimin e kodit zgjedhor;
- D. Respektim i së drejtës dhe lirisë së partive dhe kandidatëve të tjerë për të organizuar fushatën dhe paraqitjen e platformave të tyre qeverisëse;
- E. Respektimi i të drejtës së votuesve për të marrë informacion të plotë nga shumë burime dhe për të ndjekur takimet elektorale të partive të tjera;
- F. Përqëndrimi në ballafaqimin e platformave të kandidatëve apo partive në vend të luftës elektorale mbështetur në shpifje për të rrënuar kundërshtarin politik;
- G. Garantimin e lirisë së shprehjes të kandidateve dhe partive kundërshtare për përdorur gjuhën që nxit dhune apo sjellje të pahijshme;
- H. Garantimin e mbulimit të fushatës nga media dhe lirisë së tyre për t'u shprehur mbi fushatën;
- I. Përdorimi i mekanizmave ligjore për t'u ankuar dhe e fundit pranimi i rezultatit zyrtar zgjedhor dhe i vendimit të institucionit që vendos mbi ankimet zgjedhore.

Standartet për një sjellje etike në fushatat zgjedhore varen shumë nga konteksti social dhe politik i një vendi. Megjithatë, ka parime bazë që kërkohen për të arritur në zgjedhje të lira dhe të ndershme. Kjo lloj etike bazohet mbi bindjen se shërbimi publik është besim publik. Besnikëria dhe përpjekjet e administratorëve të procesit elektorale apo të zyrtarëve të tjerë që lidhen me zgjedhjet garantojnë duke zbatuar kushtetutën, kodin elektorale apo ligjet e tjera.

Gjithashtu ekzistojnë standarte etike lidhur me zgjedhjen e vëzhguesve të huaj apo vendas. Ata duhet të respektojnë sovranitetin e vendit ku monitorojnë, të njohin mirë kuadrin ligjor zgjedhor si edhe të sigurojnë akreditim ligjor përpara fillimit të misionit të monitorimit. Vëzhgimi i tyre duhet bërë në mënyrë profesionale dhe të paanshme pa ndërhyrje në procesin zgjedhor apo mbi opinionin e votuesve. Ata mund të ndërhyjnë në instancat e administratës zgjedhore vetëm kur standartet e procedurave ligjore injorohen ose thyhen qartazi. Subjektet elektorale dhe kandidatët e tyre duhet të informohen mbi përmbajtjen e misioneve

monitoruese. Natyrisht që standart themelor i veprimtarisë së monitoruesve mbetet raportimi i saktë, për fallsifikim dhe ekzagjerim të procesit zgjedhor aspektet e të cilit duhet të jenë vëzhguar në mënyrë kuptimplote. Dyshimet mbi paanshmërinë e vëzhguesve do ta dëmtonin procesin zgjedhor.

Në gjykimin mbi proceset zgjedhore në Shqipëri duhet konsideruar fakti që vitet e fundit ato damkosen disa muaj përpara zhvillimit të tyre nga vetë pjesëmarrësit e garës elektorale. Kjo taktikë nuk mund të ndihmojë kurrë në përmirësimin e zhvillimit të zgjedhjeve. Në këtë mënyrë marrëdhëniet politike acarohen më tej dhe humbet mundësia e konstruktivitetit në sjelljen e partive politike dhe mungesa e besimit rritet.

Ekzagjerimi mbi defektet teknike të proceseve të funditelektorale ka shkaktuar shmangjen e respektimit të plotë të standarteve ligjore në vendimmarrjen parlamentare që lidhet me procesin e ardhshëm zgjedhor. Këtë e pranoi edhe ambasadori i OSBE-së në Tiranë, Vacek. Mesa duket për të garantuar pranueshmërinë e rezultatit zgjedhor edhe organizmat ndërkombëtare të tolerojnë standartet përballë presioneve prej mistrecësh të politikës shqiptare.

Opozita shqiptare ka përdorur damkosjen e proceve zgjedhore për të shmangur zhvillimin e analizave serioze pas humbjes disa herë rradhazi të zgjedhjeve, analiza që mund të nxirrnin në pah përgjegjësinë për lidërshpin përkatës. Kjo përgjegjësi mund të çonte në riformatim të bllokut politik opozitar.

Shpresohet që numërimi i përqëndruar i votave të garantojë transparencë dhe besueshmëri të procesit zgjedhor. Modeli britanik është konsideruar dhe nga ekspertët ndërkombëtarë si rrugëdalje nga sherrnaja tipike shqiptare që shoqëron përfundimin e proceseve zgjedhore.

Megjithatë, pikëpyetje të mëdha mbeten përpara. A do të mundet lidërshpi i vjetër politik të sillt ndryshe kësaj rradhe? A do ta pranojnë të gjitha palët rezultatin zyrtar të zgjedhjeve? Dhe më në fund: A do të japë dorëheqje ai që do të udhëheqë humbjen e zgjedhjeve?

5. Etika si shprehje e pjekurisë së mediave dhe demokracisë

Aleksandër Çipa

Mirësjellja ka munguar në politikën shqiptare të periudhës së tranzicionit postkomunist. Ajo ka qenë zëvendësuar intensivisht nga konflikti dhe përplasia politike. Ndërkohë që në shërbim të kësaj natyre për vite dhe periudhë të gjatë mbeti më së shumti shtypi dhe, disi më pak, media elektronike e vendit. Në këtë natyrshmëri lidhjeje, ka spikatur përgjatë kësaj periudhe edhe një mungesë e theksuar profesionalizmi dhe neglizhenca etike. Në momentet e mbërritjes së tureve elektorale dhe përgjatë fushatave të konkurimit elektorale politik, kjo lidhje shërbimi e shtypit me politikën ka qenë thellësisht e shfaqur dhe ashpërsisht e shprehur.

Përdhosja politike e etikës profesionale në shtyp

Janë dy periudha të përdorimit të pamëshirshëm politik të shtypit dhe për rrjedhojë edhe e përdhosjes së etikës dhe kriterëve profesionale. Së pari është periudha e viteve 1991-1994 dhe më pas 1997-1999. Ky pasqyrim i së keqes që mbartte politika në faqet e shtypit dhe në mediat e tjera audiovizive, në këto dy periudha, përkon njëherësh edhe me nivelin e demokracisë në vend. Në raportet e reja që krijonte shoqëria me këtë rend, natyrisht që kishte sfida për t'u kapërcyer, por kishte edhe paqartësi. Disniveli në masat e shoqërisë do të krijonte mospërputhshmëri dhe disproporcione që s'mund të mos preknin edhe mediat. Mirëpo,

ndërgjegjia e elitës politike dhe insistimi i saj për ta shndërruar median në një shërbyese të keqe, në këto dy periudha, ishte tepër flagrante. Duhet thënë se pikërisht gjatë viteve 1995-1997 kishte periudha që mediat inicionin veprime politike të opozitës së atëhershme dhe i shërbenin edhe më tepër intensifikimit të përplasjes. Në këtë rol dhe ndërhyrje të tyre, mediat kryesisht të shkruara, krijojnë precedentin e gjenerimit të politikës, sikur të ishin institucione politike. Pikërisht në këtë periudhë në shtypin pluralist shqiptar spikat nëpërkëmbja e kriterit profesional të respektimit të palëve, të shprehjes së të vërtetës, sipas zërave të saj dhe të pasqyrimin të realitetit pa qenë në pozita protagonizmi dhe subjektivizmi gazetari dhe editori. Në këtë periudhë në shtypin shqiptar spikati një ndarje mediash proqeveritare dhe antiqeveritare. Media të pavarura në relacion me politikën, ishte vështirë të gjeje. Por pse ndodhi kjo? Pse humbi etika profesionale dhe pse u përdhosën kriteret klasike të gazetarisë?

Ishin shumë faktorë dhe padyshim erdhën shumë rrethana. Duhet pohuar fakti se kjo ishte periudha më e egër e tranzicionit demokratik që përshkonte shoqëria shqiptare. Tradita ishte tepër e largët, madje aq e largët sa ishte bërë e huaj. Reminishencat me mediat dhe publicistikën e viteve '30, ishin shumë të pakta dhe gjithësesi shkolla shqipe e gazetarisë demokratike nuk njihej prej brezit të publicistëve të viteve '90-të. Ndërkohë siç e pohuam, elita politike e vendit ishte në të njëjtin qorrrokak, kur kishte fituar një vizion të ri, por ende nuk kishte një dimension kulturor me tërësi njohjeje për destinacionin e ri të cilit i ishte drejtuar. Pjekuria dhe qetimi shoqëror do të duhej kohë të arriheshin. Përdhosja e etikës profesionale në vend ndodhi kryesisht për tre arsye: Së pari sepse periudha e demokracisë erdhi përmes një prologu të egër, ku ndeshja mes së vjetrës komuniste dhe së resë demokratike u bë mbi kriteret radikale. Nuk kishte kohë dhe nerva për selektim dhe referencë vlerash. Së dyti: antagonizmi politik mes kastës së vjetër dhe pinjollëve të tyre si dhe elitës së re që po merrte fatet qeverisëse të vendit ishte i thellë dhe shumëplanësh. Në këtë kuadër mediat të prirura dhe të angazhuara për përmbysjen, sidomos në vitin 1991-1992, nuk mund të respektonin për arsye të atyre rrethanave dhe konteksteve kriterin e barazshprehjes dhe barazartikulimit të palëve. Në këtë plan gjenerata e re jo vetëm politike, por edhe mentarët e rinj të këtij ndryshimi, meritonin më

tepër kohë dhe sipërfaqe botimi.

Periodha e mëvonshme, ajo e viteve 1997-1998, duhet quajtur periodha edhe më e vështirë dhe më kritike e profesionalizmit publicistik dhe mediatik shqiptar. Kriteret e së vërtetës u përdhosën keqaz. Sistemi i informimit u përdor si askurrë ndonjëherë dhe editorët shqiptarë të gjendur nën presionin e pashëmbëllt dhe nën rrezikun eminent të jetës, nuk kishin se si të mos lejonin këtë deformim. Nga ana tjetër pikërisht në këtë periudhë marrëdhëniet mes shtypit dhe shtetit rikthyen rastin klasik të instalimit të censures shtetërore. Kujtojmë me këtë rast se në vitin 1997 u ngrit Komiteti zyrtar i Censurës. Pra, në këto kushte në praktikën mediatike shqiptare ishte rikthyer edhe një rast unikal, ai i humbjes së kriterëve të lirisë dhe të profesionalizmit të lirë. Kriteret klasike të ushtrimit të profesionit, u përjashtuan dhe në Shqipëri u shtua edhe një rast unikal, i përfshirë tashmë në të gjitha manualët e rasteve të censurës dhe të mospasjes së lirisë profesionale publicistike dhe mediatike. Në këtë periudhë etika publicistike pësoi një tjetër dhunim të përmasshëm, nga ana tjetër profesionalizmit iu imponua një kompleks i ri dhe një tutelë e re.

Për këto arsye, duke ardhur në vitin 2000 në Tiranë, analisti i njohur i BBC-së për Europën Juglindore, Gabriel Partosh, nënvizonte në një bisedë televizive se: “Tranizicionin tuaj të egër e njoh përmes shtypit dhe mediave”. Deduksioni i tij për vlerësimin social dhe politik të gjendjes së vendit tonë, bashkëshoqërohej edhe me një vlerësim profesionisti për nivelin profesional, etik dhe demokratik të mediave dhe shtypit në vend.

Sfidat për të fituar etikën profesionale

Në marrëdhëniet e medias shqiptare me audiencën dhe lexuesin ka pasur dhe ende ka momente sprovash. Janë evidente periudhat e ndëshkimit dhe humbjes mes tyre. Aktualisht kemi një histori të re të këtyre marrëdhënieve, kur tituj të famshëm të shtypit të këtij tranzicioni, kanë humbur lexuesin, sikundër ekrane, ndonëse edhe me liçensë kombëtare, kanë zbritur në nivele dhe shikueshmëri të kapërcyeshme edhe nga media lokale. Popse kangjarë diçka e tillë? Për shumëkënd, si përgjigje e parë e kësaj pyetjeje vjen, pohimi: se u keqpërdor nga pronari ose pronarët dhe së dyti se u përdorën me konceptin e të qenit “kamzhik”, “mjet gjobvënije”, ose edhe

më keq. U bë organ apo ekran i këtij apo atij politikani. Në këtë mënyrë, për periudhën që flasim, në praktikën mediatike shqiptare u evidentua një imazh tjetër i shkeljes së etikës profesionale. Për motiv të interesit apo interesave, e vërteta dhe informacioni i servirur prej editorëve të kësaj apo asaj medieje, nuk respektonte kriteret e të qenit maksimalisht apo normalisht e besueshme, por mbartte synimin për të indoktrinuar mbi princip interesash dhe qëllimesh audiencën dhe lexuesit. Në këto raste neglizhimi dhe përdhosja e etikës profesionale ishte flagrante. Përmes këtyre rasteve antologjike, disa herë të konsideruar prej opinionit të publicistëve dhe gazetarëve profesionistë, publicistika shqiptare ekspozonte imazhin real të deformimeve të veta. Në vëmendje ilustrimi për këtë deformim, mund të kujtojmë rastin e zgjedhjes së kryeministrit në vitin 2000, ndërsa një komentues i njohur duke përcjellë informacionin për fitoren e njërit prej kandidatëve socialistë për kryeministër, e vlerësonte këtë fitore si fitore të medias që përfaqësonte. Ky rast, është përfshirë tashmë në memorialistikën publicistike të vendit, dhe padyshim që duhet të shërbejë si më i pashëmbëllti për periudhat e ardhshme.

Natyrisht sfidat për thellimin e profesionalizmit dhe të kulturës së etikës, janë edhe më të shumta. Pasurimi i përvojës, zgjerimi i konkurrencës dhe lëvizja për kontakt me shkollat e gazetarisë profesionale në botë, janë një faktor i fuqishëm për fitimin e këtyre sfidave. Nga ana tjetër, distanca e gazetarit me shërbimet politike, thellimi i kulturës institucionale, por njëherazi edhe rritja e kredencialeve të publicistikës për shkak të aftësisë së parreshtur të komunitetit të gazetarëve dhe publicistëve shqiptarë, janë premisë e fuqishme për një të ardhme tjetër. Aktualisht valenca e dijeve dhe dijenive profesionale në komunitetin e gazetarëve shqiptarë është më e lartë. Institucionet shqiptare kanë fituar gjithashtu një maturim dhe pjekuri, sikundër duhet thënë se afirmimi institucional i nëpunësve dhe elitës politike të vendit janë një tjetër mundësi për profesionalizmin në gazetarinë tonë. Përpos këtyre faktorëve, niveli dhe maturimi i demokracisë shqiptare kanë pësuar ngjitje progressive.

Deri në vitet 1998, në fjalorin politik të vet elites dhe opinionbërësve shqiptarë theksohej shpesh se “demokracia shqiptare është e brishtë”. Pas kësaj periudhe, kjo sintagmë është përjashtuar dhe sipas nivelit të marrëdhënieve shumëplanëshe,

verifikon që demokracia është në një moment të ri zhvillimi. Ky është një argument ndihmës për etikën dhe profesionalizmin në gazetarinë shqiptare. Ndërsa vëmendja për aftësim dhe shtim të vlerave etike dhe profesionale duhet ndalur tek kriteret dhe standarti i ushtrimit të profesionit, në mediat dhe shtypin shqiptar. Plejada e gazetarëve të kësaj dekade të fundit, duhet parë si një plejadë që garanton një hop të ri në ushtrimin e profesionit dhe në misionin e gazetarisë. Por për të ndodhur kjo, duhet që e gjithë e shkuara e së keqes profesionale dhe e etikës së paqenë të shihet si një kundërbotë e këtij komuniteti. Sepse siç shprehet Gëtja: “Një histori e tillë i ngjan dyqanit të atij që shet gjëra të vjetra”.

Mediat në sprovën e sezonit elektoral

Fushatat zgjedhore dhe sidomos misioni mediatik për të sjellë të plotë dhe në gjithë polifoninë e vet politike atmosferën elektorale, janë prova më e vështirë e pasurimit etik dhe profesional të editorëve, analistëve dhe gazetarëve. Në Shqipëri ky kriter bëhet edhe më i evidentueshëm për shkak të përvojës komplekse të përcjellë veçanërisht gjatë tranzicionit postkomunist. Raporti i mediave, editorëve dhe poseduesve të tyre me fushatat zgjedhore ka qenë kompromentues. Poseduesit e mediave janë mposhtur nga ofertat e palëve dhe konkurrentëve politikë, ose janë bërë shërbestarë të tyre duke nëpërkëmbur etikën dhe profesionalizmin dhe duke qenë pse jo brutalë me editorët e medias që zotërojnë. Në situatën aktuale kur vendi po mbërthehet prej kësaj atmosfere elektorale, jo vetëm në shtypin e shkruar partiak gjen tituj dhe shkrime ku mungon etika, por edhe në atë të pavarur. Në një maturi tjetër shfaqet media elektronike, ç’ka dhe vetë testimet dhe sondazhet e realizuara e pohojnë diçka të tillë.

Megjithatë, duhet thënë se sezoni elektoral ka kurbën e vet të temperaturës, ajo vjen e ngrihet për ditë e më shumë deri në aktin zgjedhor. Përvoja e afërt e tureve zgjedhore në vendin tonë ka dëshmuar se llogoret politike kanë përfshirë edhe publicistë dhe media. Në të gjitha këto raste, kemi pasur mundësinë të verifikojmë se sa larg standartit dhe etikës profesionale kanë qenë në tërësi edhe mediat tona. Por për t’u fituar kjo sfidë në plan të parë duhet vënë përgjegjshmëria ndaj misionit dhe besnikëria ndaj së vërtetës, pamvarësisht prej palëve që e synojnë

atë. Përgjegjshmëria publike është një akt i patjetërsueshëm kontribues në demokracinë e një vendi dhe në standartizimin e një shoqërie. Mediat dhe njerëzit e tyre e kanë këtë short për të qenë vijueshmërisht në nivelin e kërkuar të misionit të tyre.

Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA)

Instituti Demokratik Amerikan për Çështje Ndërkombëtare (National Democratic Institute for International Affairs), Partnerët për Ndryshim Demokratik (Partnerët Shqipëri), dhe Bordi Ndërkombëtar për Kërkime dhe Shkëmbime (IREX), janë Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA). Sfida përpara Shqipërisë është të adresojë korrupsionin dhe të krijojë një kulturë politike të hapur, pjesëmarrëse dhe transparente. Për ta përmbushur këtë, qytetarët duhet të organizohen për të devijuar fokusin e qeveritarëve nga përfitimet vetjake drejt një shërbimi më të mirë ndaj interesit publik. Konsorciumi DGA, i bazuar në eksperiencën e tij në Shqipëri dhe e gatshme me ide të reja, punon me kolegë shqiptarë dhe ndërkombëtarë për arritjen e këtij qëllimi.

Me mbështetjen e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Konsorciumi DGA ndihmon grupet civile t'i hapin dyert qeverive lokale nëpërmjet organizimit avokacisë dhe përpejkjeve vëzhguese, bordeve organizuese qytetare dhe takimeve publike. OJF-të në nivel kombëtar grupohen bashkë dhe krijojnë mekanizma të fortë për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në procesin legjislativ. Gazetarët rrisin standardet e tyre profesionale dhe u japin qytetarëve informacionin që ata duan për të ndarë opinionet dhe u japin zë ideve të tyre. Partitë politike janë më përgjegjëse ndaj publikut, shtrirjes së qytetarëve, demokratizimit të veprimtarive të brendshme dhe nxit breza të rinj udhëheqës. Zgjedhjet shqiptare do të bëhen më demokratike kur me qindra

qytetarë të marrin pjesë në aktivitetet e planifikuara për të monitoruar procesin zgjedhor. Në të gjithë këto aktivitete, gratë janë pjesëmarrëse të dalluara, kështu që ato mund të luajnë një rol në rritje, të dukshëm dhe të rëndësishëm në jetën publike.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Fletore e demokracisë : etika dhe zgjedhjet/ përg. National
Democratic Institute for International Affairs . -

Tiranë : Pegi, 2005 .

42 f. ; 20.7

ISBN 99943-705-6-1

324(496.5)

172(496.5)